

**DORACAK PËR  
EDUKATORË PËR  
INTEGRIM TË  
MËSIMIT  
EKSPERIENCIAL  
RRETH MJEDISIT  
JETËSOR DHE  
NDRYSHIMEVE  
KLIMATIKE NË  
ZBATIMIN E  
PROGRAMIT TË  
MËSIMIT DHE  
ZHVILLIMIT  
TË HERSHËM**

## IMPRESUM

### Autorë:

Kiril Arsovski-Përzho

Nikolla Neshkoski

Atinulla Niçova

Irena Ilievska

Sanja Aleksoska

Mr. Ivanka Mijiq

Dr. Gabriella Durçevska-Georgieva

Udhëzime për përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore:

Ivana Dvojakova

Përkthyes e gjuhës së shenjave:

Violeta Zgonc

Redaktor:

Mr. Mitko Çeshllarov

Redaktimi teknik:

Aneta Vasileva, Andrijana Zafirovska

Dizajni, ilustrimet dhe përpunimi grafik:

Vera Opashinov

Lektorimi:

Dejan Vasilevski

Përkthimi shqip:

Nehim Tairi

Lektorimi në gjuhën shqipe:

Luljeta Adili Çeliku

Ky doracak është përgatitur nga Byroja për zhvillimin e arsimit dhe shoqata qytetare “Eco Logic” në kuadër të projektit “Inkurajimi i fëmijëve dhe të rinjve në Republikën e Maqedonisë së Veriut për t’u bërë shtytës të ndryshimit për të zvogëluar ndjeshmërinë e komuniteteve nga ndryshimet klimatike”, i zbatuar nga UNICEF-i me mbështetje financiare të Suedisë.

## HYRJE

Një segment i rëndësishëm në procesin edukativo-arsimor në çerdhe/qendra për zhvillimin e hershëm të fëmijëve është arsimimi dhe edukimi i fëmijëve për mjedisin jetësor dhe ndryshimet klimatike. Është thelbësore që fëmijët të fitojnë njohuri për mjedisin jetësor që në moshë të vogël, të formojnë qëndrime dhe vlera për të mbrojtur mjedisin jetësor nga ndotja dhe për të ruajtur një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër, si dhe të ndër marrin iniciativa dhe aktivitete për të siguruar një mjedis jetësor më të pastër dhe më të shëndetshëm. Në këtë mënyrë shoqëria do të formojë brezat e ardhshëm të cilët do të edukohen për mjedisin jetësor, me vetëdije më të madhe mjedisore dhe të cilët do të kujdesen me përgjegjësi për natyrën dhe botën e gjallë në të.

Në programin e mësimin dhe zhvillimit të hershëm për fëmijët, duke u bazuar në standardet e mësimin dhe zhvillimit të hershëm, studimi i mjedisit jetësor është i integruar në një sërë përmbajtjesh, si dhe veçanërisht në kuadrin e fushës së Zhvillimit dhe përvetësimit kognitiv të njohurive të përgjithshme. Për të arritur me sukses rezultatet e pritura të përcaktuara në Programin për mësimin dhe zhvillimin e hershëm, është e nevojshme të zbatohen aktivitete edukative cilësore dhe kreative në kuadër të temës së planifikuar ditore, përmes së cilave fëmijët do të mësojnë në mënyrë eksperienciale për mjedisin jetësor dhe ndryshimet klimatike.

Doracaku për edukatorët që zbatojnë aktivitete edukativo-arsimore në përputhje me Programin për mësim dhe zhvillim të hershëm do t’i ndihmojë edukatorët në planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve edukative gjatë ditës, të cilat përpunojnë përmbajtje për mjedisin dhe ndryshimet klimatike. Doracaku është përgatitur me qëllim që të jetë mbështetje dhe frymëzim për edukatorët në punën e tyre për të realizuar aktivitete edukative të suksesshme dhe kreative.

Doracaku përbëhet nga 30 plane aktivitete ditore për përmbajtje të ndryshme të Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm, bazuar në standardet për mësimin dhe zhvillimin e hershëm, të cilat kanë të bëjnë me të mësuarit rreth mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike. Planet e temave ditore grupohen sipas grupmoshës (për fëmijë prej tre deri katër vjeç, për fëmijë prej katër deri pesë vjeç dhe për fëmijë prej pesë deri gjashtë vjeç). Për çdo grupmoshë, tema e planeve përgatitore ditore është e strukturuar rreth temave që mbulojnë përmbajtjen për mjedisin jetësor: Biodiversitetin, ekosistemin, Ndryshimet klimatike, Zhvillimin e qëndrueshëm dhe ndotjen. Çdo planifikim i një teme ditore/përgatitje ditore i referohet një përmbajtjeje specifike që lidhet me rezultatet përkatëse të pritura të Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm që duhet të arrihen përmes zbatimit të aktiviteteve edukative.

Në të njëjtën kohë, për çdo planifikim të një teme ditore/përgatitje ditore jepen konceptet që duhet të përvetësojnë fëmijët. Gjithashtu, në përshkrimin e veprimtarive edukative, specifikohen pajisjet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e tyre.

Në kuadër të planifikimit të temës së ditës/përgatitjes ditore, u zhvilluan aktivitete edukative për realizimin e kohës në grup - aktivitete hyrëse, punë në qendrat mësimore - mësimi përmes përvojës dhe aktivitete përfundimtare - nxjerrja e përfundimeve. Aktivitetet hyrëse synojnë të aktivizojnë njohuritë e mëparshme të fëmijëve dhe t'i njohin ata me përmbajtjen. Ato kryesisht konceptohen duke ndjekur prezantime të përshtatshme vizuale, duke zhvilluar një bisedë etj. Në pjesën që i referohet punës në qendrat e mësimi/të nxëniti përmes përvojës, jepet një përshkrim i hollësishëm i aktivitetit përmes së cilit fëmijët do të eksplorojnë dhe mësojnë në mënyrë eksperienciale (përmes përvojës), si dhe një propozim për mënyrën e organizimit të punës së fëmijëve në grupe ose në çifte, me theks të veçantë në monitorimin dhe drejtimin e fëmijëve për supozimet, kryerjen e eksperimentit, vëzhgimin e ndryshimeve, regjistrimin e rezultateve dhe paraqitjen e tyre përmes vizatimit, spjegimit dhe diskutimit. Aktivitetet e planifikuara të qendrës së mësimi - mësimi përmes përvojës në këtë doracak ofrojnë një gamë të gjerë idesh për të mësuar përmes kërkimit dhe veprimit krijues. Aktivitetet përfundimtare, nga ana tjetër, synojnë të nxjerrin përfundime të sakta dhe të duhura. Pjesa e fundit e planifikimit të temës së ditës/përgatitjes ditore është reflektimi, në të cilin ofrohen pyetje për të përmbledhur dhe lidhur atë që është mësuar me jetën e përditshme të fëmijëve, si dhe pyetje se si janë ndjerë ata gjatë realizimit të aktiviteteve edukative dhe sa ka qenë interesant ai aktivitet për ta.

Në fund të çdo planifikimi të temës së ditës/përgatitjes ditore, jepet një link/vegëz me një version video të eksperimentit të përfshirë në aktivitetet kryesore, i cili i mundëson mësimdhënësit të ketë një pasqyrë konkrete për të organizuar dhe realizuar më mirë punën eksperimentale gjatë procesit edukativo-arsimor gjatë asaj dite. Përgatitjet ditore, pjesë përbërëse e këtij doracak, edukatorët mund t'i përdorin si ide për aktivitete përmes së cilave do të arrijnë rezultatet e pritura gjatë zbatimit të përmbajtjeve të sipërpërmendura të Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm. Aktivitetet mund të merren siç janë dhënë në doracak, ato mund të përshtaten ose modifikohen sipas ideve të mësimdhënësit, nevojave dhe interesave të nxënësve dhe përparimit të tyre në procesin mësimor, mjeteve të punës në dispozicion, kushteve në çerdhe/qendrën për zhvillim të hershëm të fëmijëve, etj. Ato përfaqësojnë shembuj të shkëlqyeshëm se si mësimi përmes përvojës rreth mjedisit dhe ndryshimeve klimatike mund të integrohet në punën edukativo-arsimore me fëmijët e moshës parashkollor në pajtueshmëri me Programit për mësimi dhe zhvillim të hershëm. Pritet që ky doracak, përveç se do të jetë një mbështetje për edukatorët në planifikimin dhe realizimin e procesit edukativo-arsimor, njëkohësisht të jetë edhe një nxitje për kreativitet, motivim dhe entuziazëm edhe më të madh në punë.

## Udhëzime për përfshirjen e nxënësve me aftësi të veçanta arsimore në realizimin e aktiviteteve

Aktivitetet e këtij doracak mundësojnë përfshirjen e të gjithë nxënësve, pavarësisht aftësive, kapaciteteve dhe njohurive të mëparshme. Në raste të caktuara, edukatorët do të duhet të bëjnë përshtatje të caktuara të aktiviteteve. Kur vendosni se si të përshtatni metodat, format dhe mjetet e punës për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, është e rëndësishme t'u përgjigjeni pyetjeve të mëposhtme:

- A mundet fëmija të marrë pjesë në të njëjtën mënyrë si bashkëmoshatarët e tij/me fëmijët?
- Nëse nuk mundet, a mund ta bëjë aktivitetin me materiale dhe mjete të përshtatura?
- Nëse nuk mundet, a mund ta bëjë aktivitetin në çifte apo grupe të vogla?
- Nëse nuk mundet, a mund ta bëjë aktivitetin me ndihmën e herëpashershme të një të rrituri (edukatori/ja)?
- Nëse nuk mundet, a mund ta bëjë aktivitetin me ndihmën e drejtpërdrejtë të një të rrituri (edukatori/ja)?
- Nëse nuk mundet, a mund të bëjë një aktivitet tjetër që i përshtatet njohurive dhe mundësive të tij?

Përgjigja e këtyre pyetjeve jep drejtim se si të përshtaten ose modifikohen aktivitetet. Realizimi i aktiviteteve me fëmijë me nevoja të veçanta arsimore nuk mund të realizohet në mënyrë të planifikuar më parë. Në raste të tilla, gjëja më e rëndësishme është të ndiqni nevojat e fëmijës, brenda mundësive tuaja.

Përshtatjet ose modifikimet që do të bëhen për zbatimin e aktiviteteve duhet të bazohen në një vlerësim të mëparshëm të fëmijës, përkatësisht në potencialin, aftësitë dhe nevojat e tij për mbështetje, në përputhje me qëllimet e përcaktuara në planin individual arsimor të fëmijës.

Më poshtë jepen udhëzime që mund të jenë të dobishme në përshtatjen e hapësirës, kohës, materialeve, komunitetit dhe qasjes ndaj punës me fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.

### Organizimi i orarit ditor dhe përcaktimi i kohës për realizimin e aktivitetit:

- Është e dëshirueshme që prezantimi i orarit ditor të jetë vizual duke përdorur figura në mënyrë që fëmijët të dallojnë dhe kuptojnë se për çfarë aktiviteteve po bëhet fjalë.
- Fleksibiliteti është i dëshirueshëm dhe nëse fëmija me nevoja të veçanta arsimore nuk ka mundësi të marrë pjesë për momentin, atëherë aktiviteti shtyhet nëse e lejon orari ditor.

### Organizimi i hapësirës dhe mjedisit të punës

- Është e nevojshme të sigurohet një mjedis i njohur dhe i sigurt duke hequr pengesat fizike.
- Vendi ku do të kryhet aktiviteti duhet të jetë i qasshëm, ndërsa materialet të jenë lehtësisht të qasshme për t'u trajtuar.
- Duhet të reduktohen sa më shumë stimujt e jashtëm që mund të ndikojnë në shqisat dhe të shpërqendrojnë pa nevojë vëmendjen (zhurma, drita).

- Fëmijët organizohen në një mënyrë që optimizon mundësitë për komunikim, ndërveprim dhe mësim për të gjithë - me fokus të veçantë te fëmijët me nevoja të veçanta arsimore të cilët përballen me pengesa për të mësuar, zhvillim dhe pjesëmarrje.

#### Përzgjedhja e materialeve dhe mjeteve të punës

- Në kuadër të përgatitjes merren parasysh aftësitë e fëmijës për të trajtuar në mënyrë të sigurt materialet e parashikuara për realizimin e aktivitetit. Nëse fëmija përdor materiale të personalizuar (p.sh. mbajtëse për ngjyra, mbajtëse për stilolapsa, brusha për ngjyrosje etj.), atëherë ato përdoren gjatë realizimit të aktiviteteve.

- Nëse deri më tani fëmija nuk ka punuar me disa nga materialet e ofruara, atëherë është e nevojshme të diskutohet me prindërit dhe anëtarët e ekipit gjithëpërfshirës për mundësinë e futjes së tyre në punën e përditshme të fëmijës.

- Fleksibiliteti dhe zbatimi i strategjive të ndryshme janë të nevojshme gjatë punës me materiale në mënyrë që fëmija të mund t'i manipulojë ato më lehtë (për shembull, në vend që të lyejë me kolazh, ai mund të pikturojë ose të prodhojë në formate më të mëdha nëse fëmija ka vështirësi me aftësitë motorike).

#### Komunikimi

- Edukatori/ja jep kërkesa të shkurtra dhe të thjeshta, përdor komunikimin joverbal dhe komunikimin nëpërmjet fotove dhe videove.

- Fëmijët inkurajohen dhe nxiten të komunikojnë (p.sh. duke bërë pyetje të thjeshta).

- Edukatori/ja tërheq vëmendjen e fëmijëve vizualisht, verbalisht ose fizikisht.

- Fëmijët inkurajohen të mësojnë përmes komunikimit të ndërsjellë, të shkëmbejnë përvoja dhe të hulumtojnë në mënyrë të pavarur (për shembull, të shikojnë libra ose enciklopedi, të kërkojnë në internet në lidhje me temat që mbulojnë aktivitetet).

#### Edukatori/ja respekton vendimet e fëmijëve

#### Vëmendja dhe përqendrimi

- Para fillimit të aktivitetit, edukatori/ja duhet të jetë i sigurt se ka vëmendjen e fëmijës. Për këtë qëllim, në tavolinë apo në hapësirë nuk duhet të ketë gjëra që do të shpërqendronin vëmendjen e fëmijës.

- Edukatori/ja ndihmon fëmijët në organizimin e hapësirës dhe materialeve.

- Koha e aktivitetit rregullohet sipas vëmendjes dhe përqendrimit të fëmijës. Nëse është e nevojshme, bëhet një pushim i shkurtër, gjatë të cilit fëmija mund të bëjë ndonjë detyrë që e relakson. Edukatori/ja shënon fillimin dhe mbarimin e pushimit dhe mandej fëmija vazhdon me detyrën.

- Përdoren kohëmatës vizualë që tregojnë se sa minuta kanë mbetur për aktivitetin.

- Vëmendja dhe përqendrimi janë një “ushtrim” sipas qasjes “hap pas hapi” gjatë zbatimit të aktiviteteve.

### Përvetësimi i nocioneve të reja

Gjatë realizimit të aktiviteteve, kur fëmijët me nevoja të veçanta arsimore ndeshen me nocione dhe koncepte të panjohura për ta, atëherë mund të zbatohen udhëzimet e mëposhtme:

- Përdoren fjalë dhe fjali të thjeshta me mbështetje shumëshqisore (fotografi ose ilustrim, video, objekt konkret, një prodhim nga aktiviteti).
- Përdoret një kombinim i metodave të ndryshme të punës: metoda e demonstrimit, spjegimit, ilustrimit, lojës etj.
- Detyrat dhe aktivitetet ndërlidhen me përvojën e fëmijës.
- Fëmija përfshihet në diskutim, me pyetje që korrespondojnë me aftësitë dhe mënyrën e tij të komunikimit.
- Planifikohet dhe parashikohet kohë e mjaftueshme për përsëritje të koncepteve që mbuloohen në orë.

### Niveli i përfshirjes dhe mbështetjes gjatë aktivitetit

- Në varësi të aftësive të fëmijës dhe interesimit të tij për aktivitetin konkret, bëhet vlerësimi se cilat aktivitete mund të kryejë në mënyrë të pavarur ose me mbështetje. Kjo mbështetje mund të ofrohet nga bashkëmoshatarët dhe/ose edukatori/ja.
- Mbështetja e bashkëmoshatarëve është mjaft e rëndësishme sepse krahas përshtatjeve apo modifikimeve të tjera, kontribuon shumë në përfshirjen më të madhe të fëmijës me nevoja të veçanta arsimore në aktivitet. Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme për fëmijët e tjerë sepse u mëson atyre ndjeshmëri, mosdiskriminim dhe barazi.
- Mbështetja e bashkëmoshatarëve mund të përfshijë: ndihmë për trajtimin e materialeve, kujtimin e hapit të ardhshëm të aktivitetit, disa spjegime në lidhje me aktivitetin etj.
- Është e nevojshme të praktikohet puna në grup të vogël ose puna në çifte, ku fëmija me nevoja të veçanta arsimore do të ketë mundësi të përfshihet dhe të ndërveprojë me bashkëmoshatarët e tij.
- Edukatori/ja përdor lavdërimin, shpërblen dhe inkurajon fëmijën gjatë aktivitetit.



**ZHVILLIMI I  
QËNDRUESHËM**



**MOSHA**

**PREJ 4 DERI 5 VJEÇ**


TITULLI I TEMËS: Zhvillimi i qëndrueshëm

TITULLI I TEMËS DITORE: Një instrument nga paketimi i ripërdorur

GRUPI I SYNUAR: Fëmijë të moshës prej katër deri pesë vjeç

REZULTATET E PRITURA:

- Dallon instrumente të caktuara muzikore dhe i përdor ato.
- Kombinon teknika të ndryshme arti dhe ripërdor materiale në procesin e krijimit të një instrumenti muzikor.
- Zhvillon ndërgjegjësimin ekologjik dhe njeh rëndësinë e ripërdorimit për të mbrojtur mjedisin jetësor nga ndotja.



### • PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:

#### • KOHA NË GRUP - AKTIVITETE HYRËSE

Aktivitetet fillojnë me fëmijët të ulur në dysheme në formë rrethi, ndërsa në mes të rrethit edukatorja hedh ambalazhe të ndryshme të përdorura (shishe, kavanoza, kapakë, tuba, qese 'smoki', etj.). Çdo fëmijë merr një ambalazh/paketim dhe e përshkruan atë, dhe gjithashtu jep disa përgjigje të shkurtra të nxitura nga pyetjet:

- Për çfarë kanë shërbyer ambalazhet?
- Si duken ata?
- A mund të na shërbejnë për diçka tjetër të tillë, të përdorur?
- Çfarë ju kujton pamja e tyre?
- Si mund t' u japim një qëllim të ri?

Pas diskutimit, fëmijët dëgjojnë muzikë nga instrumente të ndryshme dhe përipiqen të gjejnë instrumentin.

Në këndin e muzikës edukatorja tregon para fëmijëve disa instrumente për fëmijë: ksilofon, dajre, daulle për fëmijë, fizarmonikë, sintetizator e të tjera. Fëmijët njihen me instrumentet, emërtojnë instrumentin dhe duke rrotulluar instrumentet, secili fëmijë prodhon një tingull të caktuar.


#### • PUNA NË QENDRA - MËSIMI PËRMES PËRVOJËS

Fëmijët ndahen në grupe të vogla (nga pesë deri në tetë fëmijë) sipas qendrave mësimore (qendra e artit, matematikës, letërsisë dhe muzikës). Secili grup kryen aktivitete të caktuara dhe detyra të caktuara me materiale të disponueshme në secilin grup. Edukatorja drejton punën në qendra.

Grupi i parë i fëmijëve punon në qendrën e artit dhe fillon me ngjyrosjen e kapakëve të shisheve prej qelqi, nga dy në çdo ngjyrë. Fëmijët, sipas dëshirës së tyre, zgjedhin ngjyrat tempere dhe fillojnë me ngjyrosjen.

Ata i varin kapakët në kapëse për tharje rrobash dhe fillojnë të lyejnë nga të gjitha anët, duke i mbajtur për kapëset e rrobave. Edukatori/ja drejton dhe ndihmon, nëse është e nevojshme.

Fëmijët vendosin kapakët e ngjyrosur pranë një dritareje ose një ngrohësi për të përshpejtuar procesin e tharjes së kapakëve.



Grupi i dytë i fëmijëve drejtohet në qendrën e matematikës. Fëmijët ndahen në disa çifte dhe fillojnë duke e prerë kartonin në dy shirita të gjatë (afërsisht 14 centimetra gjatësi dhe 3,8 centimetra gjerësi). Fëmijët krahasojnë gjatësitë duke përdorur pëllëmbën e dorës dhe shohin nëse janë të njëjta, i palosin ato në gjysma të barabarta dhe konfirmojnë parashikimin e tyre.

Grupi i tretë i fëmijëve punon në qendrën e letërsisë, ku përmes librave të ndryshëm për punimet e dorës shikojnë prodhimin e instrumenteve, etj., nga materialet që tashmë janë përdorur. Idetë e tyre ua përcjellin gojarisht fëmijëve të tjerë dhe bisedojnë me njëri-tjetrin.

Edukatori/ja cakton një grup fëmijësh të cilët kontrollojnë nëse kapakët janë tharë në qendrën e artit dhe më pas i mbushin me ngjites të lëngshëm (mund të përdoret edhe ngjites silikoni për ta bërë më të lehtë ngjitjen) pranë majës së kapakut. Pasi kapakët janë mbushur plotësisht me ngjites, edukatori/ja drejton secilin fëmijë individualisht që t'i përforcojë bukur e mirë sipër ngjitesit nga kapakët në kartonët e përgatitur tashmë (të përforcuara mirë dhe të thara). Fëmijët fillojnë me përdorimin e instrumenteve, përkatësisht trokitësve brenda qendrës muzikore. Secili grup punon në rotacion dhe përdor trokitësit e bërë nga materiali i ricikluar.

Edukatori/ja zhvillon një diskutim përmes pyetjeve:

- Për çfarë e ripërdorët ambalazhin/paketimin?
- Për çfarë mund të përdoret paketimi tashmë i përdorur?
- Si ju pëlqejnë tingujt e instrumenteve tuaja të bëra?
- Cilat janë idetë tuaja për të realizuar vepra të tjera krijuese?
- Si e ndihmojmë mjedisin duke ripërdorur paketimin e përdorur?

Fëmijët u përgjigjen pyetjeve dhe me gojë spjegojnë procesin krijues të prodhimit të instrumenteve që mund t'i përdorin çdo ditë brenda qendrës muzikore.


## • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE - NXJERRJA E PËRFUNDIMIT

Gjithçka që është bërë në qendrat mësimore u prezantohet të gjithë fëmijëve të grupit. Zhvillohet një diskutim dhe nxirren përfundime se ambalazhet tashmë të përdorura, kapakët etj., çdo ditë ato mund të ripërdoren për një qëllim tjetër, përkatësisht për të bërë produkte kreative dhe kështu të mbrojmë planetin Tokë nga mbeturinat dhe ndotja.

## • REFLEKTIM:

- Çfarë bëmë sot?
- Si u ndjetë gjatë ripërdorimit të paketimit?
- Çfarë mësuat?
- Si mund ta zbatoni atë që keni mësuar në jetën tuaj të përditshme?

Trego si u ndjeve sot:



TITULLI I TEMËS: Zhvillimi i qëndrueshëm / Menaxhimi i mbeturinave dhe ripërdorimi i tyre  
TITULLI I TEMËS DITORE: Enë krijuese (ripërdorimi, ripërdorimi i objekteve dhe enëve të vjetra, ripërdorimi i letrës së vjetër, ripërdorimi i plastikës, mbeturinave)  
GRUPI I SYNUAR: Fëmijë të moshës katër deri në pesë vjeç  
REZULTATET E PRITURA:

- Kupton procesin e ripërdorimit të objekteve të vjetra dhe letrës së vjetër për të zvogëluar mbetjet.
- Mban në mënyrë të pavarur gërshërët me njërën dorë dhe në mënyrë të pavarur pret letrën në dorën tjetër.
- Jep sugjerime se si një lodër ose një objekt tjetër mund të përdoret për një qëllim tjetër.



### • PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:

#### • KOHA NË GRUP - AKTIVITETE HYRËSE

Për realizimin e këtij aktiviteti, fëmijët duhet të sjellin nga shtëpia disa enë plastike që do të shërbejnë si model për krijimin e enëve krijuese nga letra e vjetër. Edukatori/ja ka përgatitur paraprakisht tre enë me të njëjtën teknikë të artit - 'kaskadimi', me të cilat do të punojnë edhe fëmijët. Edukatori/ja drejton bisedën me temën e ripërdorimit të objekteve të vjetra dhe letrës së vjetër për të zvogëluar mbeturinat dhe parashtron pyetjet e mëposhtme:

- Çfarë ndodh me letrën e vjetër?
- Pse krijohen mbeturina nga letra e vjetër?
- A bëni edhe ju mbeturina nga letra e vjetër? Shpjegoni pse?
- Çfarë do të ndodhë nëse hidhni në natyrë mbeturinat e vjetra të letrës?
- Si mund të përdoret ndryshe letra e vjetër për të zvogëluar mbeturinat?

Zhvillohet një diskutim në lidhje me pyetjet e parashtruara.

Më pas, edukatori/ja spjegon teknikën e artit të kaskadimit dhe si mund të bëni art nga mbeturinat, duke treguar fotografi interesante të artit të bërë nga mbeturinat dhe letrat e vjetra.

#### • PUNA NË QENDRA - MËSIMI PËRMES PËRVOJËS

Fëmijët ndahen në grupe më të vogla (nga katër deri në gjashtë fëmijë) në qendrat mësimore (qendrën letrare, hulumtuese dhe artistike). Secili grup merret me aktivitetin e tij. Materialet e punës vendosen në qendrat mësimore dhe edukatori/ja jep udhëzime të qarta për punën.

Grupi i parë i fëmijëve punon në qendrën e letërsisë, ku edukatori/ja i cakton secilit fëmijë detyrën për të zgjedhur revista të vjetra për fëmijë dhe letra me ngjyra. Nga revistat e vjetra, fëmijët duhet të përdorin gërshërë për të prerë copa të formave të ndryshme gjeometrike (katrorë, drejtkëndësha, trekëndësha ose rrathe) që do të shërbejnë për kryerjen e teknikës së kaskadimit. Presin edhe forma të ndryshme gjeometrike nga letrat me ngjyra që do të përdoren për të dekoruar enët. Fëmijët presin me gërshërë duke ndjekur shembullin e treguar nga edukatori/ja.



Grupi i dytë në qendrën hulumtuese po punon për përgatitjen e enëve krijuese dhe përgatitjen e ngjitësit. Edukatori/ja demonstron dhe shpjegon se si fëmijët duhet ta mbështjellin enën me qesen e tejdkushme (foli), përkatësisht si mbështillet ena. Me ndihmën e edukatorit, fëmijët e mbështjellin një enë nga jashtë me një shtresë të hollë të tejdkushme, në mënyrë që pasi të jenë tharë t'i nxjerrin më lehtë nga enët plastike. Përgatitet ngjitësi (një tretësirë e ngjitësit për letër dhe pak ujë). Me kujdes, me një furçë, aplikohet ngjitësi. Mandej, shtohen letrat e vjetra copë-copë derisa fëmijët ta kenë mbuluar të gjithë enën me copa letre të vjetër. Pasi fëmijët të kenë përfunduar procedurën e teknikës artistike të kaskadimit, edukatori/ja shpjegon se enët krijuese duhet të thahen për dy ditë dhe i udhëzon fëmijët që t'i vendosin enët në një tepsi sa më afër dritares.

Në qendrën e artit, edukatori/ja u jep detyrë fëmijëve që të dekorojnë enët krijuese paraprakisht të përgatitura. Me ndihmën e formave gjeometrike të prera paraprakisht nga letrat me ngjyra dhe materiali dekorativ, fëmijët krijojnë dekorime për enët.

Në fund, në qendrën e punimeve të fëmijëve organizohet një ekspozitë e këtyre punimeve.

#### • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE - NXJERRJA E PËRFUNDIMIT


Fëmijët së bashku me edukatorin/en bëjnë një vlerësim estetik të punimeve. Fëmijët nga secili grup vëzhgojnë enët e përgatitura dhe japin mendime dhe sugjerime se çfarë mund të bëhet për t'i bërë ato të duken edhe më mirë. Ku dhe si mund t'i përdorim këto enë në jetën tonë të përditshme? Diskutohet mënyra e ripërdorimit të letrës së vjetër dhe krijimi i veprave artistike duke ripërdorur materialet e mbeturinave, me qëllim zvogëlimin e mbetjeve.

Pas disa ditësh, fëmijët do të mund të përsërisin procedurën e dekorimit të veprave të tyre.

• REFLEKTIM:

Edukatori/ja bën pyetje:

- Çfarë bëmë sot?
- Cila ishte më interesante nga aktivitetet e sotme?
- Çfarë mësuat dhe si mund ta zbatoni atë që mësuat në jetën e përditshme?
- Në çfarë mënyre tjetër mund të ripërdoret letra e vjetër?
- Trego si u ndjeve sot?



**MOSHA**

**PREJ 5 DERI 6 VJEÇ**



TITULLI I TEMËS: Zhvillimi i qëndrueshëm


TITULLI I TEMËS DITORE: Si rriten bimët?

(farë, mbjellje, bimë)

GRUPI I SYNUAR: Fëmijë të moshës nga pesë deri në gjashtë vjet

REZULTATET E PRITURA

- Spjegon me fjalë të veta procesin e rritjes të bimës.
- Vendos farën në ujë dhe parashikon se çfarë do të ndodh.
- Numëron se cilat kushte i nevojiten bimës që të rritet (toka, dielli, ajri, uji).



### • PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:

#### • KOHA NË GRUP - AKTIVITETET HYRËSE

Aktiviteti fillon me bisedë për bimën në oborrin e çerdhes. Fëmijët vëzhgojnë bimët e mbjellura dhe diskutojnë për pamjen e tyre. Edukatori/ja i nxit me pyetje:

- Ku rriten bimët
- Çfarë u nevojitet që të rriten?
- Çfarë janë këto topa të vegjël në lulen e bimës?

Edukatori/ja u tregon farat dhe ua jep në pëllëmbë të dorës që të mund të shohin mirë.

- A mund të rritet bima nga kjo farë?
- Çfarë i nevojitet që të rritet?


Edukatori/ja i nxit ta vëzhgojnë kopshtin dhe të vërejnë kushtet që janë të nevojshme për farat që të rriten në bimë.

#### • PUNA NË QENDRA - MËSIMI PËRMES PËRVOJËS

Fëmijët ndahen në grupe të vogla (prej katër deri në gjashtë fëmijë), në qendrat për mësim (qendra hulumtuese, manipulative dhe artistike). Secili grup do të realizojë një aktivitet. Në qendrat për mësim janë vendosur materialet e nevojshme për punë, kurse edukatori/ja jep udhëzime të qarta për punë fëmijëve në qendrat për mësim.

Grupi i parë i fëmijëve punon në qendrën hulumtuese. Edukatori/ja më parë ka përgatitur llojet e ndryshme të pemëve, mes të cilave edhe avokado.

- Pse është e rëndësishme të hamë llojet e ndryshme të pemëve?
- A rriten këto pemë në mënyrë të njëjtë?
- Si mendoni, ku rritet avokadoja?
- A janë këto pemë njësoj? (krahasojnë avokado të pjekur dhe të papjekur)
- Si dallohen ato?



- Si e kanë lëvozhgën? (të lëmuar apo të ashpër)
- Kush ka provuar avokadon?
- Çfarë mendoni, si do të jetë ngjyra e avokados në brendësi, pasi që ta presim?

Fëmijët e nuhasin dhe shijojnë avokadon e pjekur. E vëzhgojnë brendësinë e pemës. E prekin dhe nuhasin farën në pjesën qendrore të frutit.

Edukatori/ja sqaron se sot do të përgatisin për të mbjellur farat e avokados. U ndihmon fëmijëve të fusin kruaset e dhëmbëve në to, që të varet lehtësisht në hapjen e një gotë. Pastaj, mbushim një gotë me ujë dhe konstruktimi i bërë nga fara e varur në katër shkopinjtë prej druri (shkopinj për mish në në skarë ose kruese për dhëmbë) e vendosin në majë ne gotës me ujë.

- Pse na nevojitet ujë?
- Çfarë tjetër u nevojitet bimëve që të rriten?
- Ku do të jetë më mirë të vendosen farat në hapësirën tonë të aktiviteteve?

Fëmijët sërish diskutojnë për kushtet e domosdoshme për mbijetesën e bimëve.

Grupi i dytë i fëmijëve punon në qendrën manipulative/natyrale. Edukatori/ja përgatit paraprakisht llojet e ndryshme të farave, setin për hulumtim dhe enë për rënditjen e farave sipas madhësisë dhe ngjyrës. Fëmijët vëzhgojnë lloje të ndryshme të farave. Edukatori/ja i nxit të krahasojnë dhe hulumtojnë.

- A mund të zbuloni se cilave pemë u takojnë farat?
- Si është forma, madhësia dhe ngjyra e tyre?
- Fëmijët përdorin mjetet për hulumtim (piskatore, xham zmadhues).
- Çfarë u nevojitet farave që të rriten?
- A mund të mbjellim farë të fasules (groshës) dhe të rritet në domate?

Në kanaçe të plastikës në pambuk të tretur me ujë i vendosin farat dhe i vendosin pranë dritares. Fëmijët do të kontrollojnë rritjen e farave dhe do të evidentojnë në ditarin e tyre hulumtues.

Në qendrën hulumtuese, fëmijët nxiten me ngjyra druri në mënyrë vizuale të tregojnë rritjen e bimës nga fara në frut. Edukatori/ja u tregon bimën në saksi dhe i pyet fëmijët për pjesët nga të cilat përbëhet. Në dorën tjetër u tregon disa fara dhe i nxit që të përkujtohen në shëtitjen në kopsht dhe në kushtet që i nevojiten bimëve që të rriten. Në fund, fëmijët prezantojnë punimet e tyre në qendrën për ekspozimin e punimeve të fëmijëve dhe spjegojnë se si rriten bimët. Derisa punojnë fëmijët, edukatori/ja drejton dhe udhëheq punën e tyre, mundëson rotacion të fëmijëve në qendrat për mësim, që të mundën të gjithë fëmijët përmes përvojës të nxisin proceset e tyre të të menduarit, njohuritë dhe proceset e të menduarit.

#### • AKTIVITETET PËRFUNDIMTARE - NXJERRJA E PËRFUNDIMIT

Pasiqë fëmijët të përfundojnë me aktivitetet në qendrat për mësim, zhvillohet diskutimi përmbyllës, kurse edukatori/ja shtron pyetje:

- Për çfarë po flasim sot?
- Si rriten bimët?
- Cilat kushte u nevojiten që të rriten?
- Si të përgatisim farën për mbjellje?
- Çfarë vëreni gjatë vëzhgimit me xhamin zmadhues?


Në fund luajnë lojë: Ku rriten të gjitha? Shënohen pjesët në hapësirën për aktivitete me fotografi “në tokë”, “nën tokë”, “në dru”. Fëmijët nxjerrin fotografi nga pemë dhe perime të ndryshme dhe duhet të ndalen në vendin përkatës në hapësirën për aktivitete.

Edukatori/ja udhëheq bisedën me fëmijët për përshtypjet nga aktivitetet e realizuara në qendrat për mësim të hershëm dhe u sqaron se do të duhet të kenë durim dhe të ndërrojnë ujin e farës të avokados në periudhë prej dy javësh. Vijon procesi i vëzhgimit të vazhdueshëm të ndryshimeve derisa të mbijnë dhe mbillen në tokë.

#### • REFLEKTIM:

Edukatori/ja i nxit të zhvillojnë diskutim të ndërsjellë dhe të bisedojnë për atë se si janë ndjerë derisa kanë hulumtuar?

- Çfarë punuam sot?
- Çfarë ishte më interesante?
- Çfarë mësuam?
- Ku mund të zbatojmë atë që kemi mësuar në jetën e përditshme?
- Tregoni si je ndjerë sot.



TITULLI I TEMËS: Zhvillimi i qëndrueshëm  
TITULLI I TEMËS DITORE: E bëjmë Rruzullin tokësor  
GRUPI I SYNUAR: Fëmijët e moshës prej pesë deri gjashtë vjet  
REZULTATET E PRITURA:

- Fiton njohuri për pamjen dhe formën e Rruzullit tokësor
- Shfrytëzon më shumë materiale dhe teknika artistike në modelimin e planetit Tokë



### • PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:

#### • KOHA NË GRUP - AKTIVITET HYRËSE

Aktivitetet fillojnë me ndarjen e fëmijëve në katër grupe dhe para çdo grupi vendoset aplikacion me ngjyrë të planetit Tokë.

Edukatori/ja e drejton bisedën me fëmijën përmes pyetjeve:

- Si është forma e planetit Tokë?
- Cilat ngjyra janë të përfaqësuara në planetin Tokë?
- Kush jeton në planetin Tokë?

Për prezantim më të qartë, para fëmijëve vendoset globi dhe fëmijët me kujdes vëzhgojnë pjesët e gjelbra, të kaltra, të verdha dhe kafe të planetit Tokë dhe mes tyre zhvillojnë biseda dhe ndajnë mendimet e tyre për planetin.

#### • PUNA NË GRUPE - MËSIMI PËRMES PËRVOJËS

Fëmijët ndahen në grupe më të vogla (nga pesë deri në tetë fëmijë) dhe ndahen në qendra për mësim (për matematikë, hulumtim dhe art)


Në qendrat për punë vendosen materialet e nevojshme për punë, kurse edukatori/ja jep udhëzime të qarta për punë të fëmijëve në qendra.

Së pari, fëmijët flasin mes tyre përmes vëzhgimit të globit që vendoset para tyre dhe mund të analizojnë mirë dhe të krahasojnë me punimet e tyre të ardhshme.

Edukatori/ja ndan me secilin grup (gjithsej katër grupe) balona që varen/ngjiten me shiritë ngjites/duplofan në enë më të thellë (përmes të cilit nuk do të humbet ekuilibri).

Grupi i parë i fëmijëve punon në qendrën e matematikës, ku edukatori/ja jep udhëzime për prerjen ose grisjen e shiritëve nga gazetat e vjetra.

Fëmijët mes tyre krahasojnë formën, gjatësinë dhe gjërësinë e shiritave (gjatësi rreth 15-20 cm dhe gjërësi rreth 2 cm).



Edukatori/ja nxit diskutim për përdorimin e gazetave të vjetra ose, për letrën që tashmë kemi përdorur që të mund ta përdorim sërish.

Biseda nxitet përmes këtyre pyetjeve:

- Për çfarë përdorim letrën?
- Ku rreth nesh mund të gjejmë letra?
- Si fitohet letra?
- Ku mund ta ripërdorim?

Pas diskutimit, edukatori/ja drejton një apo më shumë fëmijë të cilët në ditët e ardhshme do të jenë përgjegjës për ruajtjen e letrës që tashmë kanë përdorur.

Fëmijët do të vendosin shiritët e prerë në enë dhe çdo grup (katër grupe të ulur rreth katër tavolinave) merr nga një enë. Pastaj, edukatori/ja fillon që të përziej përbërjet e miellit dhe ujit (mundet ujë të ngrohtë nga çezma) me çrast fitohet ngjitësja natyrale (përzierje e dendur si një llojë paste/brum për petulla) që ndahet sipas grupeve në enët e thella.

Fëmijët fillojnë të vendosin ngjitësen në shirita - duke tretur shiritat në enët me ngjitëse (me ndihmën e gishtave dhe pëllëmbëve të dorës) ose me ndihmën e furçave.

Fëmijët ngadalë fillojnë të ngjisin të gjithë shiritat e balonave që qëndrojnë para tyre. Edukatori/ja i nxit fëmijët në diskutim përmes këtyre pyetjeve:

- Në çfarë ju ngjan balona e ngjitur?
- Çfarë mendoni, çfarë do të ndodhë kur të thahet ngjitësja?
- Si të thahet më shpejtë ngjitësja?
- Si duket planeti Tokë (para tyre)?

Fëmijët japin ide të ndryshme për tharjen më të shpejtë të modeleve të ngjitura të planetit Tokë. Edukatori/ja drejton, ndërsa fëmijët thajnë katër planetet e ardhshme të Tokës me ndihmën e tharëses (fenit)

Grupi i tretë fillon me punë në qendrën e artit, ku para tyre janë vendosur ngjyra të ndryshme tempere me të cilat ngjyrosin planetin Tokë. Përmes imagjinatës të tyre dhe fantazisë përcaktojnë se si ngjyrosen. Pas përfundimit të ngjyrosjes, planetet e formuara të Tokës vendosen në qendrën për ekspozimin e punimeve të fëmijëve.


## • AKTIVITET PËRFUNDIMTARE - NXJERRJA E PËRFUNDIMIT

Para të gjithë fëmijëve prezantohen punimet e planeteve të Tokës dhe gjithçka është punuar gjatë ditës në qendrat për mësim.

Zhvillohet diskutim dhe merret përfundim për formën, ngjyrën dhe rëndësinë e planetit tonë Tokë.

### • REFLEKTIM:

- Çfarë bëm sot?
- Çfarë dëshironi të bëni sërish?
- A ishte interesant aktiviteti?
- Çfarë mësuat?
- Tregoni se si ndjeheni sot.



TITULLI I TEMËS: Zhvillimi i qëndrueshëm/ripërdorimi

TITULLI I TEMËS DITORE: Mulli me erë prej letre (energjia e erës, mullirit me erë, burimet e ripërtërishme, ripërdorimi i materialeve, ripërdorimi i letrës të vjetër)

GRUPI I SYNUAR: Fëmijët e moshës nga pesë deri në gjashtë vjeç

REZULTATET E PRITURA:

- Identifikon burime të energjisë (erë, ujë që rrjedh, motorr etj) tek objektet e ndryshme në lëvizje.
- Bën dallime ndërmet lëvizjes të shpejtë, më të shpejtë, shumë të shpejtë dhe të ngadalshme, më të ngadalshme dhe shumë të ngadalshme.
- Ë kupton rëndësinë dhe përdorimin e energjisë së erës si burim i ripërtërishëm i energjisë.



### • PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:


#### • KOHA NË GRUP - AKTIVITETE HYRËSE

Aktivitetet filluan me ushtrime për zgjatjen dhe frymëmarrjen e thellë të muzikës të relaksuar. Të ulur në rreth, fëmijët realizojnë ushtrimin “dielli dhe ylli”. Të shtrirë në stomak, fëmijët mbahen për duarsh me kokën drejtë mesit të rrethit dhe formojnë diellin, kurse këmbët janë “rrezet e diellit”. Në shenjen e dhënë, ata zgjaten me duart dhe këmbët. Pastaj kthehen në shpinë dhe në qendrën e rrethit preken me këmbët, kurse duart vendosin mbi këmbë. Gjithashtu në shenjen e dhënë, fëmijët zgjaten dhe formojnë “yllin”.

Fëmijët shohin filmin e shkurtër dokumentar për mullinjtë me erë. Edukatori/ja gjatë shikimit pauzon me qëllim që të jap spjegime më të hollësishme për mullinjtë me erë dhe rëndësinë e tyre. Zhvillohet diskutim për pyetjen:

- Çfarë forme ka mulliri me erë?
- Në çfarë ju ngjan?
- Për çfarë është shfrytëzuar në të kaluarën?
- Si mund të shfrytëzohet energjia e erës?
- Sa i madh mund të jetë mulliri i erës?

Edukatori/ja jep informacione se rrymimi i ajrit ose erës posedon energji që mund të transformohet në energji elektrike ose mekanike me ndihmën e gjeneratorëve nga mullinjtë me erë. Energjia e fituar përmes pajisjeve të ndryshme (transformues) transformohet në lloj të tretë të energjisë që nevojitet në jetën e përditshme të njeriut. Gjatë prodhimit të tillë të energjisë elektrike nuk shkarkohen gazra të dëmshme, prandaj nuk ka efekt negativ mbi atmosferën. Gjithashtu nuk ka efekt negativ mbi mjediset ujore, dhe nuk ka prani të mbeturinave në sistemet e mullinjve me erë. Energjia e erës shfrytëzohet prej shumë më parë. Mullinjtë e parë me erë janë shfrytëzuar për bluarje dhe ujitje.



## • PUNA NË QENDRA - MËSIMI PËRMES PËRVOJËS

Aktivitetet vazhdojnë edhe në qendrën për hulumtim, letërsi dhe art. Fëmijët ndahen në grupe të vogla dhe realizojnë aktivitete sipas udhëzimeve të dhëna nga edukatori/ja.

Grupi i parë i fëmijëve në qendrën për hulumtim bën mullirin me erë prej letre me ndihmën e edukatorit/es. Ai i përfshin fëmijët në aktivitet përmes bisedës për ripërdorimin e letres të vjetër dhe se si në këtë mënyrë mund të mbrohet natyra. Që të mundet natyra të jetë më e mbrojtur nga ndikimet e dëmshme, mund të përdoret energjia e erës për krijimin e llojeve të tjera të energjisë me ndihmën e gjeneratorëve.

Edukatori/ja fillon me krijimin e mullit me erë prej letre, duke shpjeguar procesin në hapa.

Hapat të cilat duhet të ndiqen:

1. Prisni një katror (të vizatuar më parë nga ana e edukatorit).
2. Palosni për gjysëm, diagonalisht, duke bashkuar skajet për të krijuar trekëndësh.
3. Palosni sërish në dy pjesë, përmes diagonales tjetër.
4. Hapni katrorin
5. Çdo vijë e vizatuar me lakim (diagonalisht) prisni deri në gjysëm me gërrshërë.
6. Merrni gjilpërë dhe bëni vrimë në këndin e sipërm të majtë të çdo trekëndëshi.
7. Bëni edhe një vrimë në qendrën e katrorit.
8. Shponi me një shtypës apo gjilpërë në të gjithë vrimat e bëra dhe shtypni drurin ose në laps që të shtrëngohet mirë.
9. Nëse gjilpëra është shumë e gjatë, shkurtoni me darë.
10. Nëse dëshironi mjedis më fortë të katrorit, ngjisni një pjesë të vogël të kartonit në formë të rrethit ose katrorit.

Grupi i dytë në qendrën për letërsi kanë detyrë të shqyrtojnë enciklopeditë me fotografi me temë mullinj të me erë, kurse fëmijët nga grupi i tretë në qendrën për art në një faqe të bllokut vizatojnë mullin me erë në mjedis të pastër natyror. Aktivitetet përfundojnë në oborrin e kopshtit, ku fëmijët kontrollojnë nëse mullinj të me erë që i kanë bërë kthehen mirë. Lëvizin me vrap në oborr me mullinj të me erë.




## • AKTIVITETET PËRFUNDIMTARE - NXJERRA E PËRFUNDIMIT

Para të gjithë fëmijëve prezantohet gjithçka që është punuar gjatë ditës. Zhvillohet diskutim, kurse fëmijët vijnë në përfundime se pse disa nga mullinjët me erë rrotullohen për dallim nga të tjerat. Potencohet se mund të ripëdoret letra e vjetër dhe lapsat ose drunjët e vjetër që të bëhen mulli me erë prej letre. Pasiqë të kontrollohet funksionaliteti i mullinjve me erë prej letre, vendoset ekspozita e mullinjve me erë prej letre.

## • REFLEKTIM:

- Çfarë mësuat sot?
- A ishte e lehtë të bëhet mulli me erë prej letre?
- Si të mbrojmë natyrën sot?



TITULLI I TEMËS: Zhvillimi i qëndrueshëm


TITULLI I TEMËS DITORE: Plastelinë e shtëpisë

(plastelinë e shtëpisë, zhvillim i qëndrueshëm, ripërdorim i materialeve, mbrojtja e planetit, sjellja e përgjegjshme e njeriut)

GRUPI I SYNUAR: Fëmijë të moshës prej pesë deri gjashtë vjeç

REZULTATET E PRITURA:

- Numëron disa mënyra të ripërdorimit të materialeve nga jeta e përditshme.
- Bëj figura të kafshëve, shtëpisë, personazhe nga materiale të ndryshme për formësim (plastelinë dhe brumë)
- Përdor materiale natyrale në formësim dhe modelim.



### • PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:

#### • KOHA NË GRUP - AKTIVITET HYRËSE

Aktivitetet fillojnë me ushtrime për frymëmarrje dhe dëgjim të muzikës relaksuese me tinguj të natyrës. Zgjaten dhe hyjnë në temë përmes bisedës për blerje si dukuri në jetën e njeriut. Biseda shkon në këtë drejtim:

- Pse duhet të blejmë gjëra të ndryshme?
- Pse na nevojiten produktet nga dyqani?
- Çfarë mund të blejmë?
- A mund të bëjmë vetë diçka?


Fëmijët sillen në situatë të mendojnë dhe të thonë se edhe vetë mund të bëjnë diçka. Të ulur në rreth, edukatori/ja lexon librin me fotografi të vëllimit “Mendo në mënyrë të barabartë” - “E dua planetin tim”. Biseda vazhdon në atë drejtim se është e rëndësishme që fëmijët të mësojnë se si të bëjnë punë dhe sende të caktuara pa i blerë. Kështu, sendet e caktuara me ndryshim të vogël mund të ridedikohen për nevojë tjetër dhe të ripërdoren, dhe kështu mbrohet mjedisi natyror nga mbeturinat e shumta.

#### • PUNA NË QENDRA - MËSIMI PËRMES PËRVOJËS

Fëmijët ndahen në grupe të vogla dhe hapet qendra për hulumtim, art dhe letërsi. Në qendra janë të vendosura materialet, kurse edukatori/ja demonstroi recetën për të bërë plastelinë në qendrën për hulumtim. Grupi i parë i fëmijëve në qendrën për hulumtim vëzhgon demonstrimin e eksperimentit.

Fëmijët njihen me përbërësit e nevojshëm për të bërë plastelinën e shtëpisë. Spjegohen të gjithë hapat për përgatitjen e tij. Në plikën e vogël elektrike, edukatori/ja në enën për gatim shton përbërësit dhe përgatit plastelinën e shtëpisë sipas recetës.

Receta:



- 1 gotë miell
- ½ gotë kripë
- 2 lugë vaj
- 1 gotë ujë
- gjysëm qese me acid limoni (mund të jetë edhe pluhur për fryrje)
- ngjyra ushqyese sipas dëshirës (mundet ngjyra në qese)

Përzihet brumi, kripa dhe acidi i limonit. Vendoset ujë në enë për gatim, shtohen të gjithë përbërësit e thatë dhe përzihet derisa nuk barazohet masa, dhe pastaj shtohet vaji. Ena vendoset në plitkën elektronike, ngrohet në zjarr mesatar me përzierje të vazhdueshme, që të mos digjet. Kur përzierja do të fillojë të ndahet nga skajet e enës dhe do të bëhet homogjene, largohet nga plitka elektrike. Në fund, pasi që të bëhet plastelina, lihet që të ftohet dhe fëmijët shtojnë ngjyra ushqyese sipas përzgjedhjes së tyre.

**VËREJTJE:** Proveni plastelinën e ftohur dhe nëse është shumë ngjitëse dhe nuk është i mirë për modelim, ktheni sërish në plitkën elektrike dhe përzieni edhe pak. Filloni me përzierje, që të bashkohen përbërësit e përzierjes. Nëse brumi ngjitet për duarsh, atëherë shtoni më shumë brum.

Pasi që do të përgatitet plastelina, në qendrën e artit, fëmijët modelojnë dhe formësojnë sendet e preferuara, grupi i tretë në qendrën e letërsisë hulumton dhe shqyrton libra me punime krijuese nga material tjetër natyral dhe jep ide për eksperimentin e ardhshëm.


#### • AKTIVITETET PËRFUNDIMTARE - NXJERRJA E PËRFUNDIMIT

Në fund të modelimit, fëmijët prezantojnë se çfarë kanë bërë nga plastelina e shtëpisë. Në plastelinë mund të shtohet edhe pak vanilje për aromë më të mirë. Edukatori/ja i udhëzon fëmijët se këtë plastelinë mund të bëjnë edhe në shtëpi me prindërit e tyre. Gjatë gjithë procedurës përmendet se vetëm në prani të personit të rritur mund të përgatitet plastelinë e tillë dhe theksohet se ky eksperiment mund të jetë i rrezikshëm për fëmijët.

• REFLEKTIM:

Edukatori/ja zhvillon bisedën me fëmijët për përshtypjet nga aktivitetet në qendra dhe shtron pyetje:

- Çfarë bëm sot?
- Si mund të zbatojmë atë që mësuam në jetën e përditshme?
- Si ndjeheni gjatë aktiviteteve?



# EKOSISTEMI



**MOSHA**

**PREJ 4 DERI 5 VJEÇ**

TITULLI I TEMËS: Ekosistemi

TITULLI I TEMËS DITORE: Ndhimë bletëve

GRUPI I SYNUAR: Fëmijë të moshës prej katër deri pesë vjeç

REZULTATET E PRITURA:

- Përshkruan karakteristikat dhe rolin e bletëve.
- Zhvillon kujdesin për bletët, ndërsa me këtë edhe kujdesin për ekosistemet në përgjithësi.



## • PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:

### • KOHA NË GRUP - AKTIVITET HYRËSE



Aktivitetet fillojnë përmes lojës imituese “Tingulli i bletës”. Fëmijët njihen me temën dhe nxjerrin tingujt e bletëve duke mbyllur veshët me gishtin tregues, marrin frymë dhe duke nxjerrë frymën gumëzhijnë si bletë.

Së pari, të gjithë gumëzhin menjëherë, ndërsa më pas edukatori/ja i ndan fëmijët në dy grupe. Së pari njëri grup dëgjon dhe tjetri gumëzhin. Nëpërmjet diskutimit të ndërsjellë, fëmijët tregojnë nëse grupi ka krijuar vërtet zërin e bletëve dhe më pas ndërrojnë rolet.

Edukatori/ja, në qendrën e letërsisë, lexon disa fakte për bletët nga një enciklopedi dhe ua paraqet fëmijëve. Fëmijët, të ndarë në disa grupe, e ndajnë enciklopedinë me njëri- tjetrin dhe shikojnë bletët, si dhe përbërësit, produktet dhe vendbanimet e tyre.

Para fëmijëve vendosen disa fotografi didaktike të bletëve dhe më pas zhvillohet një diskutim përmes pyetjeve të mëposhtme:

- Cili është funksioni bazë i bletëve?
- Si na ndihmojnë bletët?
- Keni frikë nga bletët?
- Kur fluturojnë bletët?
- Si duken bletët?
- Çfarë japin bletët?
- Si e pinë ujin?
- Pse është e rrezikshme kur bletët pinë ujë?



## • PUNA NË QENDRA - MËSIMI PËRMES PËRVOJËS

Fëmijët ndahen në grupe të vogla (nga pesë deri në tetë fëmijë) në qendrat mësimore (qendra për lojëra me role, dramë dhe shfaqje kukullash, qendra hulumtuese dhe artistike). Edukatori/ja jep udhëzime të qarta kur cakton detyrat në qendrat mësimore, në të cilat fëmijët kanë materialet e nevojshme për realizimin e detyrave.

Në kuadër të qendrës për lojëra me role, dramë dhe shfaqje me kukulla, janë fëmijët e grupit të parë. Edukatori/ja fillon të realizojë dramën “Bleta e etur”, përmes së cilës një fëmijë caktohet të jetë bletë dhe një tjetër lule. Fëmija-bletë vendos një kukull bletë në dorën e tij, ndërsa fëmija tjetër mban lulen (lule lodër kadife) në dorë. Edukatori/ja udhëheq dhe motivon grupet.

Gjatë lojës, fëmijët aktivizohen dhe marrin rolin e bletëve, në mënyrë që me sinjalin e kukullës së bletës, fëmijët fluturojnë si bletë, tundin krahët sa të munden, ndalojnë për të pushuar dhe sërish me sinjalin e “bletës kryesore” nisin të fluturojnë, kërkojnë lulen, “përqafojnë” lulen (fëmijën-lule). Edukatori/ja udhëheq, ndërsa fëmijët marrin pjesë në mënyrë aktive në të gjitha përpjekjet për të qenë bletë. Historia mbetet pa fund, por bëhen pyetje me të cilat fëmijët do të drejtohen për të nxjerrë përfundime:

- A janë të lodhura bletët?
- A janë të uritur bletët?
- A kanë etje bletët?
- Çfarë duhet të bëjmë në njerëzit për t’iu ndihmuar bletëve?
- Dëshironi t’i ndihmoni bletët?

Pas diskutimit, fëmijët drejtohen në rolin e “shpëtimtarëve të bletëve” duke i lidhur çdo fëmijë një fjongo me një kryq të kuq mjekësor të vizatuar, që nënkupton se ato ndihmojnë bletët.

Grupi tjetër i fëmijëve vazhdon të punojë në qendrën hulumtuese. Ata ndahen në katër grupe dhe secili grup merr një kavanoz të madh qelqi dhe e mbush me ujë dhe me ndihmën dhe drejtimin e edukatorit/es vendoset një pjatë sipër kavanozit, kavanozi kthehet me kokë poshtë dhe rrjedh pak ujë në pjatën për të mbushur pjatën.

Fëmijët ndahen në çifte. Çdo çift udhëzohet të rendit guralecë midis pjatës dhe kavanozit për të nxitur rrjedhjen e ujit.



- Shkurtimisht parashtrohen pyetje që nxisin procesin e të menduarit tek fëmijët dhe jepen edhe zgjidhjet e mundshme:  
Për çfarë do të shërbejë kavanozi plot me ujë?
- Për çfarë qëllimi renditni guralecë midis kavanozitet dhe pjatës?
- Pse uji duhet të jetë i pastër?
- Si do të pinë ujë bletët?


Fëmijët e grupit të tretë në qendrën artistike/kreative fillojnë me ngjyrosjen e aplikacioneve të bletës. Secili fëmijë e dekoron bletën me ngjyra sipas dëshirës, e pret dhe e ngjijt në kavanozin që paraqet një burim uji për bletët e lodhura.

#### • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE - NXJERRJA E PËRFUNDIMIT

Të gjitha përfundimet e arritura në punën brenda qendrave u prezantohen të gjithë fëmijëve në grup. Zhvillohet një bisedë dhe nxirren përfundime të caktuara. Kavanozat vendosen jashtë çerdhës në oborr, mundësisht diku afër tokës, në mënyrë që bletët të mund të pinë ujë në mënyrë të sigurt. Fëmijët, nën drejtimin e edukatores, vëzhgojnë bletët duke pirë ujë përmes burimit të sigurt të ujit që kanë krijuar. Ata arrijnë në përfundim se kjo lloj ndihme për bletët është veçanërisht e rëndësishme për mbijetesën e të gjithë kolonisë së bletëve, dhe rrjedhimisht për prodhimin e mjaltit për ne, njerëzit dhe krijesat e tjera të gjalla.

#### • REFLEKTIM:

- Çfarë ishte më interesante për ju sot?
- Çfarë mësuat?
- Si u ndjetë duke ndihmuar bletët?
- Si mund t'i ndihmoni insektet e tjera?
- Trego si ndjehesh sot.



TITULLI I TEMËS: Ekosistemi

TITULLI I TEMËS DITORE: Borë në çerdhen e fëmijëve

GRUPI I SYNUAR: Fëmijë të moshës katër deri pesë vjeç

REZULTATET E PRITURA:

- Identifikon rajonet e Tokës të formuara nga akulli ose të mbuluara nga bora.
- Pasuron përvojat e veta përmes punës praktike.
- Zhvillon perceptimet shqisore dhe forcon pëllëmbët dhe gishtat e duarve.



### • PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:

#### • KOHA NË GRUP - AKTIVITETE HYRËSE

Aktivitetet fillojnë përmes vëmendjes së drejtuar ndaj globit të vendosur para fëmijëve. Fëmijët zhvillojnë një diskutim të ndërsjellë dhe perceptojnë sipërfaqet e bardha të planetit Tokë. Nxitet diskutimi i ndërsjellë, ndërsa edukatori/ja, nëse është e nevojshme, korrigjon dhe drejton vazhdimisht bisedën.

Në një rruzull tokësor të përgatitur tashmë (karton i butë që modelohet lehtë, 2D) fëmijët, të ndarë në tre grupe, fillojnë duke mbushur me oriz të bardhë vetëm ato pjesë të globit të Tokës që janë të bardha. Secili grup ka rolin e vet (për shembull, Polin e Jugut, Polin e Veriut, Alaskën dhe pjesët e të tjera).


Përderisa fëmijët janë duke punuar, ata vazhdimisht bëjnë krahasime, duke përdorur atlasin e fëmijëve dhe globin, duke përcaktuar kështu me kujdes vendet në planetin Tokë që janë të mbuluara me borë dhe akull. Përpara se të kalojnë në punë praktike në qendra, secilit fëmijë i jepet një kub akulli për ta mbajtur në pëllëmbët e duarve. Diskutohet ndjesia e ftohtësisë gjatë mbajtjes së kubave të akullit, më pas të gjithë kubat e akullit vendosen në një enë më të thellë dhe ena lihet deri në fund të aktiviteteve për të parë se çfarë do të ndodh, përkatësisht për të parë që akulli është shkrirë.

#### • PUNA NË QENDRA - MËSIMI PËRMES PËRVOJËS

Para se të fillohet me punën praktike nëpër qendra, zhvillohet një bisedë me fëmijët që do t'i orientojë ata drejt lojërave hulumtuese dhe eksperimentale:

- Cilat pjesë të Tokës janë të mbuluara me borë?
- Si duket bora?
- Kur bie zakonisht borë në vendin tonë?
- Ku ka më shumë borë? Pse?
- Çfarë mund të bëni me borën?

Fëmijët ndahen në grupe të vogla (katër deri në gjashtë fëmijë) në qendrat mësimore (qendra hulumtuese, qendra matematikore dhe qendra e manipulimit të materialit) dhe secili grup duhet të kryejë një aktivitet konkret me materialin



në dispozicion të shpërndarë në qendrat mësimore.

Në kuadër të qendrës hulumtuese, grupi i parë i fëmijëve fillon të krijojë borë në dhomën e aktiviteteve.

Edukatori/ja fillimisht përzieri trië gota sodë buke me gjysmë gote kondicioner para fëmijëve dhe më pas i udhëzon fëmijët të përziejnë dhe bashkojnë mirë të dy përbërësit me duar.

Vetë fëmijët e kuptojnë se dalëngadalë po krijojnë borë artificiale.

Nëpërmjet perceptimeve shqisore (prekjes dhe shikimit), fëmijët zbulojnë se nëse bora nuk merr dendësinë e duhur (është shumë e hollë ose e dendur), ata duhet të shtojnë vetë kondicioner ose sodë buke.

Grupi i dytë i fëmijëve punon në qendrën e matematikës dhe përmes një loje matematikore, e ndajnë borën në tre grupe.

Para fëmijëve vendosen tre tiganë dhe sipas udhëzimeve të edukatorit/es, fëmijët hedhin borë duke e gërmuar borën në lugë. Fëmijët numërojnë sa lugë hedhin në tiganin e parë dhe më pas shtojnë të njëjtën sasi në të gjitha tiganët tjerë. Edukatori/ja mbikëqyr dhe drejton vazhdimisht. Nëse nuk keni borë të mjaftueshme, lërin fëmijët të përziejnë më shumë kondicioner dhe sodë buke.

Grupi i tretë i fëmijëve në qendrën për manipulimin e materialeve të ndryshme luajnë lojëra të ndryshme me borën. Ata formojnë figura të ndryshme, si dhe vendbanime/habitate të kafshëve më të përfaqësuara në rajonet e ftohta: pinguinët, arinjtë polarë, lopët e detit dhe të tjerat.

#### • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE - NXJERRJA E PËRFUNDIMIT


Detyrat e ndryshme të kryera në qendra u prezantohen të gjithë fëmijëve në grup.

Vëmendja e fëmijëve drejtohet te ena në të cilën u lanë kubet e akullit në fillim të aktivitetit: Çfarë ndodhi me akullin? Pse u shkri? A do të shkrihet bora jonë? Çfarë temperature nevojitet që të mos shkrihet bora/akulli?

Fëmijët nxjerrin përfundim se ku është më e bollshme bora në Tokë, si ta dallojnë atë më lehtë, cilat kafshë jetojnë në ato zona të ftohta.

• REFLEKTIM:

- Çfarë mësuat sot?
  - Çfarë ishte më interesante për ju?
- Trego se si je ndjerë sot:



TITULLI I TEMËS: Ekosistemi


TITULLI I TEMËS DITORE: Eksperiment për portokallin

(portokall, tekstura e lëvores së portokallit, ajri, lundron, fundoset)

GRUPI I SYNUAR: Fëmijë të moshës prej katër deri pesë vjeç

REZULTATET E PRITURA:

- Njeh veçori të ndryshme të portokallit me ndihmën e shqisave.
- Bazuar në vëzhgim dhe hulumtim nxjerr përfundimeve të drejta.



### • PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:

#### • KOHA NË GRUP - AKTIVITETE HYRËSE

Me fëmijët diskutohet për portokallin: Si quhet ngjyra e portokallit? Çfarë forme ka portokalli? Si është në prekje lëvorja e portokallit (edukatori/ja secilit fëmijë i mundëson të prekë portokallin)? Çfarë erë ka portokalli (qërohet portokalli)? Çfarë shije ka?

Fëmijët renditen në rreth dhe fillojnë ushtrimet për zgjatje me muzikë relaksuese. Edukatori/ja u jep udhëzime fëmijëve të mbyllin sytë dhe të lëshohen në një udhëtim interesant - meditimi ujqor. Fëmijët marrin frymë, nxjerrin frymë dhe imagjinojnë se ndodhen në një kopsht me portokaj ku çdokush mund të prekë, merr erë dhe të shkëpusë portokaj. Me shenjën 1, 2, 3, 4, fëmijët i hapin sytë dhe tregojnë se si janë ndjerë derisa kanë pasur udhëtim të pazakontë dhe çfarë kanë parë në kopsht.

Edukatori/ja fillon me leximin e librit me fotografi “Portokaj për secilin”. Pasi ta ketë lexuar librin me fotografi, nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve do ta përpunojnë tregimin.

Edukatori/ja i pyet fëmijët për përshtypjet nga tregimi.

- Çfarë bënë fëmijët në tregim?
- A mbajti mend ndonjëri se sa portokaj kishte fëmija?
- Si i ka ndarë fëmijë portokajtë me prindërit dhe shokët?

Pasi ta ritregojnë tregimin, edukatori/ja u sqaron fëmijëve se do të bëjnë eksperiment me portokaj në qendrën hulumtuese.



### • PUNA NË QENDRA - MËSIMI PËRMES PËRVOJËS

Fëmijët ndahen në grupe të vogla (prej 4 deri 6 fëmijë), nëpër qendra për mësim (hulumtuese, artistike dhe familjare-dramatike). Secili grup duhet të realizojë aktivitetet. Në qendrat për mësim janë vendosur materialet e nevojshme për punë, ndërsa edukatori/ja jep udhëzime të qarta për punë nëpër qendrat për mësim.

Grupi i parë punon në qendrën e hulumtimit. Në tavolinë ka dy portokaj dhe një enë e madhe e tejdukshme e mbushur me ujë ose dy kavanoz me ujë. Para fillimit të realizimit të eksperimentit, bisedohet me fëmijët dhe parashtrohen pyetje që do t'i nxisin fëmijët të mendojnë, e me këtë do ta përqendrojnë vëmendjen e tyre.

Edukatori/ja demonstroi para fëmijëve dhe qëron lëvoren e njërit portokall, ndërsa tjetrin nuk e qëron. Portokajtë njëkohësisht vendosen në enën e madhe të tejdukshme me ujë ose në dy kavanozat me ujë.

Vëzhgohet se çfarë do të ndodhë. Fëmijët vëzhgojnë dhe konstatojnë se portokalli i qëruar fundoset, ndërsa ai që nuk u qërua jo. Diskutohet pse ndodh kjo. Edukatori/ja i orienton fëmijët të mendojnë se çfarë ndodh me portokajtë duke bërë edhe një eksperiment me balon. Pra, një balon të fryrë e vendos në enë të thellë me ujë dhe ndjek nëse ai do të fundoset. Fëmijët konstatojnë se për shkak të ajrit, baloni nuk mund të fundoset. Edukatori/ja i drejton fëmijët të vëzhgojnë lëvoren e portokallit. Secili fëmijë ka portokall dhe e vëzhgon lëvoren e tij me xham zmadhues ose mikroskop.

Në qendrën artistike fëmijët e grupit të dytë e vizatojnë lëvoren e portokallit me qëllim të përforcimit të dijeve të përfituara për atë që kanë mësuar nga eksperimenti.

Fëmijët e grupit të tretë në qendrën familjare-dramatike mundohen me shtrydhëse pemësh të shtrydhin lëng portokalli. Në fund, edukatori/ja ka përgatitur lëng nga portokaj të shtrydhur dhe të gjithë fëmijëve në gota të veçanta u jep të pinë nga lëngu.

## • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE - NXJERRJA E PËRFUNDIMIT


Pasi të përfundojnë eksperimentin, edukatori/ja i pyet fëmijët:

- Çfarë ndodh me portokajtë kur vendosen në ujë?
- Pse portokalli i qëruar fundoset, ndërsa i paqëruari jo?
- Çfarë vërejtët kur vëzhguat me xhamin zmadhues?

Të udhëhequr nga edukatori/ja, fëmijët konstatojnë se ajri është ajo që nuk lejon që portokalli të fundoset. Në fakt, lëvorja e portokallit ka flluska të vogla, pra xhepa ajri të cilët nuk lejojnë të fundoset portokalli për dallim nga portokalli i qëruar i

## • REFLEKTIM:

- Çfarë bëmë sot?
- A ishte interesant aktiviteti?
- Çfarë mësuat?
- Si mund ta zbatoni në jetën e përditshme atë që mësuat?
- Trego si u ndjeve sot.



TITULLI I TEMËS: Ekosistemi

TITULLI I TEMËS DITORE: Ngjyrosja e luleve të bardha

GRUPI I SYNUAR: Fëmijë të moshës prej katër deri pesë vjeç

REZULTATET E PRITURA:

- Spjegon se bimët kanë nevojë për dritë dhe ujë që të rriten.
- Dallon dhe emëron pjesë të bimës nga modeli i dhënë (lule e vërtetë ose artificiale, ilustrim të bimës etj.).
- Sjell përfundim për situatën konkrete.



### • PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:

#### • KOHA NË GRUP - AKTIVITET HYRËS

Fëmijët ulen në rreth dhe bëjnë ushtrime për frymëmarrje (merri erë lules, ndjej erën dhe nxjerr frymë).

Edukatori/ja i fut në temë me bisedë të shkurtë për ndjenjën në trup kur jemi të etur:

- Si ndiheni kur jeni të uritur?
- Si e ndjeni etjen në trup?
- Çfarë pimë kur jemi të etur?

Nëse pimë lëng boronice, a do të bëhemi ngjyrë vjollcë?

Bisedohet dhe nxitet humori te fëmijët. Secilit fëmijë i jepet gotë me ujë dhe kashtë.

Diskutohet:

- Pse pimë ujë?
- Pse na nevojitet?
- Çfarë do të ndodhë nëse nuk pimë ujë disa ditë?

Fëmijët nxiten të marrin frymë me hundë dhe në kashtë të bëjnë filluska. Ky ushtrim përsëritet 3 deri më 5 herë. Pastaj fëmijët e pinë ujin me kashtë. Tregohet lule në saksi dhe diskutimi vazhdon. Edhe kjo lule pi ujë.


- Pse ka nevojë për ujë?
- Si pi ujë?
- Çfarë do të ndodhë nëse nuk i japim ujë?

#### • PUNA NË QENDRA - MËSIMI PËRMES PËRVOJËS

Fëmijët ndahen në grupe të vogla (4 deri 6 fëmijë), nëpër qendrat për mësim (hulumtuese, letrare dhe artistike).

Grupi i parë në qendrën për hulumtime fillon realizimin e eksperimentit. Për kryerjen e tij janë të nevojshme tri lule me ngjyrë më të hapur (shembull: të bardha ose rozë), tri gota plastike të tejdukshme (mundet edhe tri epruveta të vendosura në mbajtëse), ujë dhe ngjyra ushqimore (shembull: e kuqe, e kaltër dhe e verdhë).





Në secilën gotë paraprakisht të mbushur me ujë deri në gjysmë, fëmijët shtojnë ngjyrë të veçantë ushqimore, përziejnë me lugë dhe vendosin nga një lule.

- Çfarë mendoni se do të ndodhë?

Tri gotat lihen të qëndrojnë kohë të caktuar, dhe derisa pritet të kalojë koha, fëmijët me ndihmën e mikroskopit e vëzhgojnë strukturën e tringut dhe nxiten diskutim i ndërsjellë me pyetjet:

- Si ngjitet uji nëpër tring?

- Çfarë është ajo që e lëviz ujin brenda?

- A ka ndonjë forcë me të cilën thithet uji?

Në ndërkohë, çdo ndryshim në eksperiment fëmijët e ilustronjë me vizatime në fletë blloku.

Në qendrën e letërsisë, fëmijët e grupit të dytë shfletojnë enciklopedinë për pjesët e bimës.

Diskutohet në pyetjet:

- Cilat janë pjesët e bimës?

- Për çfarë i shërben secila pjesë?

- Si kalon uji?

- Çfarë do të ndodhë nëse tringut thyhet?

- Si do të vepronin nëse dikush e thyen atë?

Në qendrën për art figurativ është përfshirë grupi i tretë i fëmijëve. Ato vizatojnë lule, pjesët e lules, si lulja pi ujë, si gëzohet, si ndihet. Edukatori/ja e ndjek, nxit dhe orienton punën e fëmijëve në grupe. Gjatë punës nëpër qendra, fëmijët qarkullojnë në grupe.

## • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE - NXJERRJA E PËRFUNDIMIT

Para të gjithë fëmijëve në grup prezantohet ajo që është punuar gjatë ditës në qendrat për mësim.

Diskutohet dhe arrihet në përfundim se lulet janë të ngjyrosura në ngjyrën e duhur që ndodhet në gotë, duke parashtruar pyetjet:


- Çfarë vëreni?
- Çfarë ka ndodhur me lulet?
- A ka ndryshuar ngjyra e luleve?
- Si u ngjyros lulja?
- Pse lulja është e ngjyrosur me të kuqe/kaltër/verdhë?
- Pse u ngjyros lulja?
- Si lëviz uji i ngjyrosur nëpër lule?
- Cilët janë pjesët e lules?

Nëpërmjet pyetjeve fëmijët arrijnë në përfundim për procesin e lëvizjes së ujit nëpër lulen/bimën.

## • REFLEKTIM:

Me fëmijët flitet për përshtypjet nga aktivitetet e kryera.

- Çfarë dinit, e çfarë mësuat?
- Cili aktivitet ju pëlqeu më shumë? Pse?
- Si ndiheni? Pse?
- Çfarë do të bëni kur të jeni në shtëpi?
- Si do të kujdeseni për bimët?



TITULLI I TEMËS: Ekosistemi/Biodiversiteti

TITULLI I TEMËS DITORE: Si rritet lulja

GRUPI I SYNUAR: Fëmijë të moshës prej katër deri pesë vjeç

REZULTATET E PRITURA:

- I përshkruan parakushtet themelore për rritje dhe zhvillim të bimëve.
- Shfrytëzon vula të gatshme (shabllonë) për shtypjen e luleve në forma dhe madhësi të ndryshme.
- Numëron disa pasoja nga mos ujitja e luleve.



### • PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:

#### • KOHA NË GRUP - AKTIVITETE HYRËSE

Aktivitetet fillojnë me ushtrime për zgjatjen e muskujve (ji falënderues si lule, qëndro si dru). Fëmijët futen në temë me bisedë për përvojat e tyre në kultivimin e luleve në kopshtin e çerdhës. Fëmijët i tregojnë përvojat e tyre dhe të nxitur nga pyetjet e edukatorit/es përshkruajnë si kujdesen.

- Çfarë i duhet lules që të jetojë?
- Si e dimë se bima është e etur dhe e uritur?
- Pse i duam lulet?

Për përqendrim më të mirë në aktivitetin e radhës me fëmijët bëjmë ushtrime për relaksim të muskujve dhe frymëmarrje: „Lulja e përgjumur“ dhe „Përshëndete diellin“.

#### • PUNA NË QENDRA - MËSIMI PËRMES PËRVOJËS

Fëmijët ndahen në grupe të vogla në qendrat për mësim: të letërsisë, të artit dhe të hulumtimit. Secili grup duhet të kryejë aktivitete. Materialet e përgatitura janë vendosur, ndërsa edukatori/ja jep udhëzime të qarta për punë.


Grupi i parë në qendrën e letërsisë shfleton enciklopedi për bimë. Diskutohet për bimë të ndryshme (perime, lule).

Grupi i dytë në qendrën artistike ka detyrë të presë dhe ngjyrosë lule sipas shablloneve të gatshme. Pasi që fëmijët të presin dhe t'i ngjyrosin lulet, në lule mund të vizatojnë simbolin e tyre sipas të cilit do ta dallojnë lulen ose edukatori/ja mund ta shkruajë emrin e fëmijës.

Grupi i tretë në qendrën e hulumtimeve merr detyrë që lulet e prera dhe të ngjyrosura t'i palosë dhe përgatisë për kryerje të eksperimentit.

Edukatori/ja para vetes ka enë të madhe me ujë dhe parashtron pyetje:

- A janë këto lule të gjalla?
- Si do t'i "ngjallim" lulet tona?



- Kush do të na ndihmojë ta bëjmë atë?

- Si mund ta shfrytëzojmë ujin në enë për t'i "ngjallur" lulet?

Fëmijëve u jepet kohë e mjaftueshme për të menduar, përgjigjur dhe parashtrim të pyetjeve, para se të realizohet eksperimenti.

Pastaj, fëmijët i vendosin lulet e palosura në sipërfaqen e ujit në enë dhe ndjekin çfarë do të ndodhë. Pasi të jenë hapur lulet e palosura, parashtrohen pyetjet:

- Pse u ngritën lulet?

- A u "ngjallën" lulet?

- Kush e bëri atë?

Në pjesën e ruajtjes dhe kultivimit të luleve fëmijët mbjellin lule, i ujisin dhe vazhdimisht e ndjekin rritjen e tyre.

Në fund, fëmijët dalin në kopsht për t'i ujitur lulet që rriten aty.

#### • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE - NXJERRJA E PËRFUNDIMEVE

Pasi të përfundojnë aktivitetet, fëmijët prezantojnë gjithçka është punuar në qendra. Bëhet diskutim i përbashkët nëpërmjet pyetjeve:

- "Çfarë ju duhet luleve që të rriten?",

- "Si ne i "ringjallëm" lulet tona?",

- "Çfarë vërejtët kur lulet "ngjalleshin"?",

- "A ka diçka që dëshironi ta bëjmë përsëri nesër dhe pse?",


- "Si duhet të kujdesemi për lulet e vërteta që ju keni mbjellë?",

- "Kush nga ju do ta bëjë atë?"

Fëmijët me përgjigjet e tyre konstatojnë se bimët, edhe ato që rriten brenda edhe ato që rriten jashtë, kanë nevojë të vazhdueshme për ujë që të mbeten në jetë.

• REFLEKTIM:

- Çfarë bëmë sot?,
- Çfarë ishte më interesante?,
- Çfarë mësuat?
- Si mund ta zbatoni në jetën e përditshme atë që e mësuat?



**MOSHA**

**PREJ 5 DERI 6 VJEÇ**

TITULLI I TEMËS: Ekosistemi

TITULLI I TEMËS DITORE: Ylberi në gotë

GRUPI I SYNUAR: Fëmijët e moshës prej pesë deri gjashtë vjeç

REZULTATET E PRITURA:

- Me fjalë tregon çfarë ka zbuluar dhe mësuar për ylberin si fenomen natyror.
- Në mënyrë të pavarur përdor materiale hulumtuese dhe e realizon eksperimentin.



### • PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:

#### • KOHA NË GRUP - AKTIVITETE HYRËSE

Ftohen fëmijët të afrohen pranë dritares përmes së cilës depërton drita. Edukatori/ja vendos gotë/kavanoz të madh në vend që mundëson qasje të sigurt të fëmijëve deri te ajo. E mbush gotën me ujë dhe i nxit fëmijët që me kujdes të vëzhgojnë derisa lëvizin përreth saj.

- A vëreni diçka në ujë?
- A ka dritë në gotë?
- Pse drita ndryshon kur e vëzhgojmë derisa jemi të kërrusur ose në këmbë?
- A vërejtë dikush nga ju ylber në gotë?


Me fëmijët diskutohet për dritën dhe si ndryshon ajo kur e vëzhgojmë nga pozita të ndryshme. Fëmijët me kujdes vëzhgojnë duke kërkuar shkëlqimin e ylberit.

- Cilat ngjyra i dalloni në gotë?
- A ka ngjyrë drita?
- A mund të ketë më shumë ngjyra?

Pasi të futen në temë dhe t'i shkëmbejnë idetë, edukatori/ja i rikujton se është koha për qetësimin e trupit dhe relaksim. Gjithë fëmijët ulen në rreth, me pozitë të drejtë të trupit. Me ndihmën e numërorit zgjidhet një fëmijë që demonstroi ushtrimin. Fëmija bën disa frymëmarrje të thella hyrëse. Pastaj fillon zgjatjen në formë të ylberit. Fëmija e mban krahun e zgjatur për 30 sekonda dhe kthehet në pozitën fillestare. Fëmijët e ndjekin fëmijën-demonstrator dhe bashkë i kryejnë ushtrimet me zgjatjen e njërit, pastaj edhe të krahut tjetër. Edukatori/ja i inkurajon fëmijët të mundohen edhe me pozita tjera të trupit të formojnë ylber. Fëmijët mundohen me formim të urës, me vizatim me këmbë në ajër, me lëvizje gjysmë rrethore të trupit t'i përgjigjen sfidës.

Pasi të përfundojnë ushtrimet, edukatori/ja parashtrohet pyetje të shkurta:

- Si ndiheni kur e imagjinoni ylberin?
- Si e quajmë formën që e krijoni me trupin tuaj?



- Si është forma e ylberit?

Vazhdohet me bisedë për atë se sa ngjyra shohim te ylberi. Fëmijët shohin video të shkurtë si krijohet ylberi dhe si duket natyra (derisa zgjat videoja fëmijëve u parashtrohen pyetje në lidhje me gjithçka që shohin).

#### • PUNA NË QENDRA - MËSIMI PËRMES PËRVOJËS

Fëmijët ndahen në grupe të vogla (nga 4 deri 6 fëmijë), nëpër qendra për mësim (hulumtues, për lojë me rërë dhe ujë, artistike, letrare).

Grupi i parë në qendrën hulumtuese, në tepsitë të madhe rendisin shtatë gota të vogla dhe në secilën prej tyre vendosin nga një ngjyrë e spektrit të ngjyrave të ylberit. Edukatori/ja i udhëzon t'i shpërndajnë ngjyrat në renditjen e duhur me qëllim që t'i përshtatet renditjes së ngjyrave në ylber. Fëmijët vendosin pluhur bikarbonat në secilën gotë. Pastaj një fëmijë njëkohësisht derdh uthull në secilën gotë. Edukatori/ja i nxit të diskutojnë duke i parashtruar pyetjet::

- Çfarë mendoni, çfarë do të ndodhë nëse shtoni uthull në gotë?

- A i shihni të gjitha ngjyrat e ylberit?

- Cilat ngjyra tjera i dalloni?

- Sa ngjyra janë shpërndarë në tepsitë?

- Ti numërojmë dhe të kontrollojmë a janë të gjitha pjesë e ngjyrave të ylberit?

Grupi i dytë i fëmijëve, në qendrën për lojë me rërë dhe ujë, në shtatë gota derdhin nga një ngjyrë nga spektri i ngjyrave që janë në ylber. Zhytin peceta letre, në mënyrë që njëri skaj është vendosur në një gotë, e tjetri në gotën tjetër.

Vëzhgojnë çfarë do të ndodhë. Edukatori/ja i nxit duke parashtruar pyetje të hapura:

- Çfarë mendoni, pse i vendosëm pecetat në atë mënyrë?

- A do të ndryshojnë plotësisht ngjyrat kur do të kontaktojnë?

- Si uji i ngjyrosur ngrihet lart në letër (fshirës kuzhine)?

- A mund të lëvizë uji?



Në qendrën artistike (të artit figurativ) fëmijët i shprehin përshtypjet dhe njohuritë e tyre për ylberin duke shfrytëzuar materiale artistike sipas dëshirës së tyre.

Në qendrën e letërsisë fëmijët shfrytëzojnë enciklopedi për natyrën dhe gjejnë fotografi në të cilat është prezantuar ylberi.

Edukatori/ja lexon tekstin nën secilën fotografi dhe i nxit të vazhdojnë diskutimet e tyre.

Derisa fëmijët punojnë edukatori/ja udhëheq punën e tyre. Edukatori/ja mundëson qarkullim të fëmijëve nëpër qendrat për mësim që të mund të gjithë fëmijët me përvojë t'i nxisin idetë, njohuritë dhe proceset mendore.

#### • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE - NXJERRJA E PËRFUNDIMIT

Pasi që fëmijët të përfundojnë me aktivitetet në qendra, bëhet diskutimi përmbyllës, ndërsa edukatori/ja parashtron pyetje:


- Sa ngjyra ka ylberi?
- Kur mund ta shohim në qiell?
- Çfarë vendosëm në gotë që të ngrihet ngjyra në të?
- Pse ngjyroset letra në gotë?

#### • REFLEKTIM:

Edukatori/ja bisedon me fëmijët për përshtypjet nga aktivitetet e kryera, i nxit në diskutim të ndërsjellë dhe për bisedë për atë se si ndihen derisa hulumtojnë.

- Çfarë mësuat sot?
- Cili aktivitet ishte më interesant?
- Si u ndjetë?

Në fund, fëmijët vallëzojnë dhe e këndojnë këngën „Ylberi“ nga “Zllatno Sllavejçe” 2006.



TITULLI I TEMËS: Ekosistemi

Titulli i temës ditore: Klorofil, ku je?

(energji, Dielli, klorofili)

GRUPI I SYNUAR: Fëmijë të moshës nga pesë deri gjashtë vjeç

REZULTATET E PRITURA:

- Spjegon pse energjia e diellit është e rëndësishme për bimët.
- Shfrytëzon veprime hulumtuese dhe paraqet procesin e lëshimit të ngjyrës së gjelbër (klorofilit) nga gjethi.



### • PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:

#### • KOHA NË GRUP - AKTIVITETE HYRËSE

Aktivitetet fillojnë me ushtrime për çlodhjen e trupit në kopshtin e çerdhes. Edukatori/ja i fut në temë duke parashtruar pyetje:

- Si ndiheni kur jeni në natyrë?
- Pse njerëzit duan të dalin jashtë në diell?
- A ju duhet dielli edhe bimëve?
- Çfarë ngjyre kanë gjethet e druve?
- Cila është ngjyra e tyre në vjeshtë?
- Çfarë mendoni, pse gjethet e ndryshojnë ngjyrën e tyre?
- Pse kur nuk ka diell gjethet e druve thahen dhe bëhen të verdha?
- Pra, çfarë ju jep dielli bimëve?


Fëmijët mbledhin gjethë të gjelbra të rëna në kullotë dhe hyjnë në dhomën e aktiviteve për t'i hulumtuar.

#### • PUNA NË QENDRA - MËSIMI PËRMES PËRVOJËS

Fëmijët ndahen në grupe të vogla (prej 4 deri 6 fëmijë), nëpër qendra për mësim (hulumtuese, ekologjike/natyrore dhe artistike). Secili grup duhet të realizojë aktivitetet. Në qendrat për mësim janë vendosur materialet e nevojshme për punë, ndërsa edukatori/ja jep udhëzime të qarta për punë nëpër qendrat për mësim.

Grupi i parë punon në qendrën hulumtuese. Fëmijët i hulumtojnë gjethet dhe diskutojnë për ngjashmëritë dhe dallimet e tyre. Edukatori/ja i nxit duke parashtruar pyetje të këtitilla:

- A janë të gjithë gjethet të lëmuara?
- Si janë skajet e tyre?
- A mund ta vëreni anën e vrazhdë?
- Çfarë ka në të?



Fëmijët hulumtojnë me ndihmën e xhamit zmadhues dhe e ndajnë atë që vërejnë te gjethi.

Parashtrohet pyetja: A vëreni topa të vegjël te gjethi?

Ata quhen klorofil dhe jepin gjetheve ngjyrë të verdhë.

Në sipërfaqen prej letre fëmijët vendosin gjethe dhe palosen me pecetë të trashë. Pastaj, me ndihmën e okllaisë shtypen gjethet.

- Çfarë vëreni?

- Çfarë ka mbi pecetën?

- Çfarë ngjyre ka?

Fëmijët vazhdojnë të hulumtojnë mbetjet në pecetë me ndihmën e xhamit zmadhues.

Grupi i dytë në qendrën ekologjike/natyrore vëzhgojnë saksi me majdanoz. Fëmijët ndajnë gjithçka që dinë për këtë bimë.

Pastaj, edukatori/ja i nxit të mendojnë me një pyetje tjetër "shkencore":

- Çfarë do të ndodhë me ngjyrën e gjetheve të majdanozit nëse nuk ka diell?

Fëmijët i ndajnë idetë e tyre dhe vazhdojnë me kryerjen e eksperimentit. E mbulojnë gjysmën e bimës me kuti kartoni dhe e nxjerrin në diell. Pas tri ditësh fëmijët do t'i vëzhgojnë ndryshimet e ndodhura dhe do t'i shënojnë në ditarët e tyre për hulumtim.

Grupi i tretë në qendrën artistike punojnë peizazhe të natyrës me ngjyrën e gjelbër (klorofilin) nga gjethi, e palosin letrën dhe e fërkojnë me lugë metalike për të fituar ngjyrë të gjelbër. Individualisht nxënësit e ndjekin procesin se daljes së klorofilit në sipërfaqe, gjegjësisht fleta e bardhë bëhet e gjelbër.

- Çfarë vëreni?

- Çfarë ka në letër?

- Cila është ngjyra e saj?

- Për çfarë e shfrytëzojnë bimët?

## • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE - NXJERRJA E PËRFUNDIMIT:

Pasi fëmijët të kenë përfunduar aktivitetet në qendrat për mësim, realizohet diskutimi përmbyllës, ndërsa edukatori/ja parashtron pyetje:


- Pse drunjtë kanë ngjyrë të gjelbër?
- Cila ishte fjala e re të cilën e mësuam sot?
- Si e gjetëm klorofilin në gjethe?
- Pse ai është aq i rëndësishëm për bimët?
- Çfarë mendoni, çfarë do të ndodhë me majdanozin pas 3 ditësh? Pse?
- Cili nga ju me padurim pret ta zbulojë këtë?

Fëmijët japin përgjigje dhe dalin në kopsht për të bërë garë kush mund të mbajë ose kalojë më shumë gjethe.

## • REFLEKTIM:

Edukatori/ja bisedon me fëmijët për përshtypjet e tyre nga aktivitetet e realizuara në qendrat për mësim të hershëm, i nxit të bëjnë diskutim të ndërsjellë dhe të flasin për atë se si ndihen kur hulumtojnë.

Gjatë tri ditëve edukatori/ja planifikon përmbajtje në lidhje me temën me qëllim të pasurimit të ideve dhe njohurive të fëmijëve për diellin dhe bimët që në mënyrë më aktive të marrin pjesë në krijimin e përfundimeve nga eksperimenti.



TITULLI I TEMËS: Ekositemi

TITULLI I TEMËS DITORE: Ku fshihet ajri?

(ajri, veçoritë e ajrit)

GRUPI I SYNUAR: Fëmijë të moshës prej pesë deri gjashtë vjeç.

REZULTATET E PRITURA:

- Numëron disa veçori themelore të ajrit.
- Mund të shërbehet me materiale të ndryshme të sigurta dhe sende nga rrethi (tokë, plastelinë, argjilë, ujë, etj.).



### • PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:

#### • KOHA NË GRUP - AKTIVITETE HYRËSE

Aktivitetet fillojnë me ushtrime për tendosje dhe frymëmarrje të thellë. Të ulur në rreth, me shpinë të drejtuar dhe këmbë të kryqëzuara, fëmijët bëjnë ushtrime për qetësimin e trupit. Secili prej tyre në dorë mban një balon. Marrin frymë thellë dhe gradualisht e lëshojnë në balon. Ushtrimi përsëritet disa herë, derisa balonat të fryhen. Edukatori/ja i pyet fëmijët me pyetje të hapura:



- Çfarë mendoni, përse fryhet baloni?
- A mund ta shohim ajrin që ndodhet brenda në të?
- A mund ta ndjejmë? Si? (gradualisht i shfryjnë balonat e drejtuar kah fytyra që ta ndjejnë ajrin)
- A e shohim ajrin në natyrë?
- Si mund ta ndjejmë?
- A fryn era gjithmonë njësoj?
- A mund të jetë era e nxehtë ose e ftohtë?
- Si quhet era e cila i "ngrin" hundët në dimër?

Me fëmijët diskutohet dhe motivohen të shikojnë video prezantim për veçoritë e ajrit..

#### • PUNA NË QENDRA - MËSIMI PËRMES PËRVOJËS

Fëmijët ndahen në grupe të vogla (prej katër deri gjashtë fëmijë), nëpër qendra për mësim (hulumtuese, për lojë me rërë dhe ujë, artistike). Secili grup duhet të realizojë aktivitetet. Në qendrat për mësim janë vendosur materialet e nevojshme për punë, ndërsa edukatori/ja jep udhëzime të qarta për punë nëpër qendrat për mësim.

Grupi i parë punon në qendrën hulumtuese ku edukatori/ja ka përgatitur dy enë me ujë. Në njërin enë ka ujë mesatarisht të ngrohtë (nga çezma, jo e shumë i nxehtë), ndërsa në enën tjetër ka ujë të ftohtë me kube akulli.



Edukatori/ja ju ndihmon fëmijëve të vendosin balon në majën e shishes plastike, në vetë grykën, dhe më pas e drejton vëmendjen e tyre kah shishja.

Së pari shishen e vendosin në enën me ujë të ftohtë dhe akull. Edukatori/ja i pyet fëmijët a vërejnë ndonjë ndryshim.

- Çfarë do të ndodhë nëse e vendosim shishen në enën me ujë të nxehtë?

- A do të ndryshojë diçka kur do ta vendosim shishen në ujin e ftohtë?

Fëmijët e kryejnë procedurën dhe i vërejnë ndryshimet. Edukatori/ja përdor pyetje për t'i nxitur fëmijët të mendojnë dhe konstatojnë:

- Si u fry baloni në shishe?

- Nga u shfaq avulli në shishe?

- A u fry baloni nga ajri i nxehtë ose i ftohtë?

- A mund të nxehet ajri?

Grupi i parë i fëmijëve në qendrën hulumtuese e përsërisin disa herë procedurën dhe i përcjellin përshtypjet nga eksperimenti i realizuar në letër.

Grupi i dytë i fëmijëve punon në qendrën për lojëra me rërë dhe ujë. Fëmijëve u jepen gota plastike dhe materiale për hulumtim: plastelinë, argjilë, tokë, sfungjer. Edukatori/ja i pyet:

- A ka ajër përreth nesh?

- A mund ta shohim?

- A ka ajër në topin prej plasteline?

- A ka në tokë, argjilë, sfungjer?

- Si mund ta kontrollojmë?

Pasi që fëmijët t'i japin përgjigjet e tyre, kanë për detyrë t'i mbushin gotat me ujë dhe në të parën të vendosin plastelinën, në të dytën argjilën, në të tretën tokën dhe në të katërtën sfungjerin.

- A vëreni flluska që shfaqen në ujë?

- Çfarë ndryshoi?

- Prej nga dolën flluskat e ajrit në gotën me tokë?
- Në cilat gota tjera ka flluska?
- Domethënë, a ka ajër në tokë?
- A kanë nevojë bimët për ajrin në tokë që të rriten? (Edukatori/ja demonstron si e tund me kujdes tokën e saksisë para se ta ujisë bimën.)

Grupi i tretë punon në qendrën artistike me detyrë ta prezantojnë ajrin nëpërmjet pikturave. Edukatori/ja paraprakisht përgatit shkumë për rroje dhe ngjyra akrilik të cilat fëmijët mund t'i shfrytëzojnë për krijimin e pikturave. Edukatori/ja ju demonstron si mund t'i përdorin materialet për të fituar ngjyra "ajri".

Fëmijët punojnë, edukatori/ja e orienton dhe udhëheq punën e tyre, mundëson qarkullimin e fëmijëve në qendrat për mësim në mënyrë që të gjithë fëmijët të mund me përvojën e vet të nxisin idetë, njohuritë dhe proceset e tyre të mendimit.


#### • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE - NXJERRJA E PËRFUNDIMIT:

Pasi që fëmijët do t'i përfundojnë aktivitetet, edukatori/ja parashtron pyetje:

- Për çfarë mësuam sot?
- A mund ta shohim ajrin?
- Si mund ta ndjejmë?
- Kur kemi ajër të ftohtë, e kur ajër të nxehtë?
- Si të ju ndihmojmë bimëve kur kanë nevojë për më shumë ajër?

#### • REFLEKTIM:

Fëmijët zgjedhin simbolin përkatës në "Semaforin e emocioneve"



TITULLI I TEMËS: Ekosistemi

TITULLI I TEMËS SË DITËS: Pamjet magjike të natyrës

(njerëz, bimë dhe kafshë)

GRUPI I SYNUAR: Fëmijë të moshës prej pesë deri gjashtë vjeç

REZULTATET E PRITURA:

- E njeh lidhjen e njeriut me natyrën, bimët, kafshët dhe varësinë e tyre të ndërsjellë.

- Spjegon pse Toka është shtëpi e përbashkët e gjithë gjallesave.



### • PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:


#### • KOHA NË GRUP - AKTIVITETE HYRËSE

Aktivitetet fillojnë me ushtrime për tendosje. Fëmijët futen në temë me dëgjimin e tingujve relaksues nga natyra. Edukatori/ja i drejton fëmijët nëpërmjet një tregimi për jetën në natyrë me teknikën “fantazi ujore” dhe i nxit fëmijët me trup të krijojnë pozita të drurit, maces, qenit, zogut, luleve etj. Përfundohet me frymëmarrje të thellë dhe përqendrim të mendjes për aktivitetin e radhës. Edukatori/ja nxit diskutim me pyetjet vijuese:

- Cilët kafshë i përmendëm në tregim?
- A mund t'i numërojmë të gjitha kafshët që jetojnë në tokë?
- E, sa bimë dini?
- A jetojnë të gjitha në planetin Tokë?
- A jemi edhe ne njerëzit banorë të Tokës?
- Si dallohen vendet ku jetojmë ne dhe ato ku jetojnë bimët dhe kafshët?
- A ka në afërsi të shtëpisë suaj ndonjë vendbanim të fshehur të insekteve, bimëve ose kafshëve?
- Si duken bimët dhe kafshët që jetojnë në afërsi të shtëpisë suaj?
- Pse ato janë të rëndësishëm për ne?
- Çfarë është gjëja më e rëndësishme për mbijetesën tonë?
- Domethënë, pse duhet të kujdesemi për bimët dhe kafshët?
- Pse për të gjitha gjallesat Toka është aq e rëndësishme?

Edukatori/ja përdor fotografi si material didaktik i cili më vonë do të përdoret për përpunimin e posterit në qendrën e artit.





## • PUNA NË QENDRA - MËSIMI PËRMES PËRVOJËS

Fëmijët ndahen në grupe të vogla (prej 4 deri 6 fëmijë), nëpër qendra për mësim (hulumtuese, për lojë me rërë dhe ujë, artistike). Secili grup duhet të realizojë aktivitetet. Në qendrat për mësim janë vendosur materialet e nevojshme për punë, ndërsa edukatori/ja jep udhëzime të qarta për punë nëpër qendrat për mësim.

Grupi i parë punon në qendrën hulumtuese ku marrin si detyrë të vizatojnë banorët e planetit Tokë në sipërfaqe të përgatitur më parë. Fillojnë me palosjen në gjysmë të letres së kuzhinës për fshirje të duarve ose letres së tualetit. Në pjesën e sipërme e sipërme të fletës e përdorin shënuesin me ngjyrë të zezë ose të kaltër për të vizatuar figurë të madhe dredhëze ose breshke dhe disa vizatime bazë të bimëve dhe kafshëve. Pastaj e shpalosin letrën e kuzhinës dhe vërejnë se vizatimi i tyre është shfaqur dhe është e dukshme sepse është kopjuar edhe në anën tjetër. Kjo është pjesa të cilën e ngjyrosin me flomasterë dhe me motivet që duan.

Në fazën e radhës me kujdes zhytet letra e palosur në enë me ujë. Njëlloj si në magji, fëmijët do të vërejnë se si konturat e vizatimit të tyre mbushen me ngjyra të mrekullueshme.

Grupi i dytë në qendrën artistik (të artit figurativ) i shfrytëzojnë aplikacionet për kafshë, bimë dhe njerëz në bisedën hyrëse me edukatorin/en dhe krijojnë poster me titull: “Banorë të planetit Tokë”.

Grupi i tretë në qendrën e letërsisë shfletojnë Enciklopedi e natyrës për fëmijë dhe njihen me lloje të ndryshme të bimëve dhe kafshëve. Edukatori/ja ua lexon tekstin nën fotografinë e cila ju lë përshtypje më të madhe.

Derisa fëmijët punojnë, edukatori/ja e orienton dhe udhëheq punën e tyre, mundëson qarkullimin e fëmijëve në qendrat për mësim në mënyrë që të gjithë fëmijët të mund me përvojën e vet të nxisin idetë, njohuritë dhe proceset e tyre të mendimit.

## • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE - NXJERRJA E PËRFUNDIMIT

Pasi që fëmijët të përfundojnë aktivitetet në qendrat për mësim, edukatori/ja i pyet:


- Kush jeton në planetin Tokë?
- Si njeriu i shfrytëzon kafshët dhe bimët?
- A do të ekzistonte natyra pa to?
- Si duhet të sillemi ndaj gjithë qenieve të gjalla?
- Pse është aq e rëndësishme kjo?

## • REFLEKTIM:

Edukatori/ja i pyet fëmijët në cilën qendër janë kënaqur më së shumti gjatë punës.

- Çfarë është ajo që më së shumë ju gëzoi sot?
- Çfarë është ajo që nuk ju pëlqeu dhe nuk do të dëshironit ta shihni ose dëgjoni përsëri?
- Çfarë do të dëshironit të bëjmë ose mësojmë herën tjetër? Pse?

Në fund fëmijët në forma simbolesh i regjistrojnë emocionet e tyre për përmbajtjet e realizuara në „Semaforin e emocioneve”.



TITULLI I TEMËS: Ekosistemi

TITULLI I TEMËS DITORE: Shiu nga retë

GRUPI I SYNUAR: Fëmijë të moshës prej pesë deri gjashtë

vjeç

REZULTATET E PRITURA:

- Tregon shiun që bie nga retë nëpërmjet kryerjes së eksperimenteve.
- Njih dhe numëron faktorët dhe kushtet për mbijetesën dhe zhvillimin e botës së gjallë.



### • PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:

#### • KOHA NË GRUP - AKTIVITETE HYRËSE

Aktivitetet fillojnë brenda oborrit të kopshtit. Fëmijët njihen me temën duke qëndruar të ulur në kullotën e oborrit ose brenda sallës së aktiviteve pranë dritareve, ndërsa edukatori/ja u cakton fëmijëve detyrë që të vëzhgojnë qiellin me re. Duke vëzhguar retë dhe qiellin, edukatori/ja nxit diskutim përmes pyetjeve:

- Si ju duken retë?
- Ku janë retë?
- Çfarë forme kanë?
- A po lëvizin ato?
- Çfarë ngjyre kanë?
- Me çfarë mendoni se janë të mbushura?
- Çfarë bie nga retë?
- Si lind shiu?

#### • PUNA NË QENDRA - MËSIMI PËRMES PËRVOJËS

Edukatori/ja i ndan fëmijët në grupe të vogla (nga pesë deri në tetë fëmijë) sipas qendrave mësimore (qendra e artit figurativ, qendra hulumtuese dhe qendra muzikore/artistike).

Secili grup duhet të kryejë një aktivitet të caktuar pas udhëzimeve të pranuar nga edukatori/ja. Para fëmijëve janë vendosur të gjitha materialet e nevojshme për kryerjen e detyrës.

Grupi i parë i fëmijëve punon në kuadrin e qendrës së arteve, ku në dritaret e klasës mbi qese-zip tashmë të ngjitura me një vizatim të shkurtër dhe qartë rreth procesit qarkor të ujit, edukatori/ja hedh pak pika uji me bojë të kaltër të tretur dhe fëmijët përmes lojës shqisore dhe manipulimit aktiv të pëllëmbëve dhe gishtërinjve (kujdes të mos i shtypin fort) vëzhgojnë qarkullimin e ujit.



Grupi i dytë i fëmijëve shkon për të punuar në qendrën hulumtuese, ku edukatori/ja i ndan fëmijët në çifte dhe secili çift merr një kavanoz ose gotë të tejdukshme gjysmë të mbushur me ujë. Edukatori/ja, duke përdorur shkumë rruajtjeje, vendos një shtresë të hollë shkumë mbi ujë. Më pas, secili fëmijë i çiftit merr ujë (nga një enë tjetër) në të cilin është tretur ngjyra e kaltër ushqimore dhe pikon përmes shkumës, pra përmes reve, duke përdorur një pikatore.

Gjithashtu, fëmijët pikojnë me pikatore dhe vaj gatimi për të parë pikën (më të trashë, më të rëndë) që depërton me sukses nëpër shtresën e bardhë të shkumës, përkatësisht nëpër retë. Fëmijët presin që "shiu" të bjerë të poshtë në ujë.

Edukatori/ja drejton me kujdes vëzhgimin e fëmijëve në procesin e daljes së pikës nga reja e bardhë dhe nxit diskutim përmes disa pyetjeve:

- Çfarë mendoni se është shtresa e bardhë, çfarë përfaqëson? (shkumë rroje)
- Çfarë do të ndodhë me pikat e kaltra?
- Çfarë përfaqësojnë pikat kaltra?
- Ku shkojnë pikat nga pikatorja?
- Pse bien pikat?

Grupi i tretë i fëmijëve në qendrën e arteve, përkatësisht në qendrën e muzikës, dëgjojnë muzikë të butë relaksuese e mandej nxjerrin një tingull/ritëm duke përdorur pëllëmbët e tyre për të tingëlluar si shiu i lehtë dhe i fortë.

#### • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE - NXJERRJA E PËRFUNDIMIT


Gjithçka që është bërë në qendrat mësimore u prezantohet të gjithë fëmijëve në grup. Zhvillohet diskutim rreth vëzhgimeve përfundimtare dhe nxjerrjes së përfundimeve për lëvizjen qarkore të ujit në natyrë, përkatësisht, ata arrijnë në përfundim se dielli ngroh ujin nga lumenjtë, liqenet, pellgjet gjatë gjithë ditës. Ai fillon të avullojë dhe shkon lart, ku më pas formohen retë dhe më pas shiu. Shiu bie përsëri në liqene, lumenj dhe pellgje, ndërsa nëse bie në tokë, formohet ujë nëntokësor. Shiu është jashtëzakonisht i rëndësishëm për të gjitha gjallesat në planetin Tokë.

• REFLEKTIM:

Bisedoni me fëmijët nëpërmjet pyetjeve të mëposhtme:

- Çfarë bëmë sot?
- Si u ndjetë gjatë krijimit të shiut?
- Çfarë ju pëlqeu më së shumti nga aktivitetet e kryera?
- Çfarë ishte më interesante për ju?
- Çfarë mësuat?
- Me çfarë dëshironi të eksperimentoni më pas?

Trego si u ndjeve gjatë ditës së sotme:



TITULLI I TEMËS: Ekosistemi

TITULLI I TEMËS DITORE: Çfarë fshihet në akull?

(akull, lëng, avull, gjendje agregate)

GRUPI I SYNUAR: Fëmijë të moshës prej pesë deri gjashtë vjeç

REZULTATET E PRITURA:

- Parashikon se çfarë do të ndodhë me ujin kur temperatura të ndryshojë, përkatësisht gjatë ftohjes ose ngrohjes.
- Kupton se çfarë do të ndodhë me akullin kur nxehet.
- Njeh ujin në natyrë në gjendje të ndryshme agregate.



### • PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:


#### • KOHA NË GRUP - AKTIVITETE HYRËSE

Aktivitetet fillojnë me ushtrime për zgjatje. Edukatori/ja i njeh me temën duke dëgjuar tingujt e valëve dhe delfinëve. Fëmijët janë ulur në dysheme me shpinën drejt dhe qetësojnë trupin me ushtrime të frymëmarrjes së thellë. Ata vazhdojnë të qëndrojnë shtrirë dhe kryejnë pozicione trupore në formën e një delfini, gaforreje, oktapodi, ylli deti, etj. Pasi mbarojnë ushtrimin, edukatori/ja i pyet për vendin që kanë imagjinuar gjatë kryerjes së ushtrimeve. Diskutimi zhvillohet duke parashtruar pyetjet vijuese:

- Pse doni të shkoni në plazh?
- Çfarë marrim zakonisht me vete kur shkojmë në plazh?
- A mund ta vendosim akulloren në një çantë shpine dhe ta marrim me vete?
- Çfarë do të ndodhë me të?
- Si të mbroni ushqimin nga dielli i nxehtë?

Edukatori/ja nxjerr akulloren nga frigoriferi i vogël dhe e vendos në një sipërfaqe të ngrohur në mënyrë që fëmijët të vëzhgojnë ndryshimet. Përderisa shikojnë akulloren të shkrihet, diskutojnë se çfarë po ndodh:

- Si ishte gjendja e akullores kur e hoqëm nga frigoriferi?
- Çfarë ndodhi me të kur e ngrohëm?
- A ka mbetur forma e saj e njëjtë?
- Të ka rënë ndonjëherë akullorja nga koni apo shkopi?
- A u shkri edhe shkopi i akullores?
- Pse qëndroi i plotë?



### • PUNA NË QENDRA - MËSIMI PËRMES PËRVOJËS

Fëmijët ndahen në grupe të vogla (nga 4 deri në 6 fëmijë), sipas qendrave mësimore (hulumtuese, artistike dhe letrare). Secili grup duhet të kryejë një aktivitet. Materialet e nevojshme të punës vendosen në qendrat mësimore dhe edukatori/ja jep udhëzime të qarta për punën e fëmijëve në qendrat mësimore.

Grupi i parë i fëmijëve punon në qendrën hulumtuese. Edukatori/ja i njofton fëmijët me eksperimentin duke demonstruar atë që ai/ajo ka përgatitur më parë për ta: një lodër e vogël në formën e një dinosauri futet në një tullumbace përmes hapjes dhe mbushet me ujë. E lidh fort me një llastik dhe e lë të ngrijë në frigorifer. Ai/ajo i pyet fëmijët se çfarë do të ndodhë me ujin në tullumbace dhe pse. Më pas ai/ajo nxjerr tullumbacet tashmë të ngrira dhe i vendos mbi tryezën e qendrës hulumtuese. Ai/ajo nxit diskutim në lidhje me pyetjet e mëposhtme:

- Çfarë mendoni se ka në tullumbace?
- Në çfarë ju ngjasojnë ato?
- Çfarë ndodhi me ujin në tullumbace?
- A është në gjendje të lëngshme?
- Çfarë ka në akull?
- A mund ta shihni dhe ta nxirrni?
- Pse nuk nxirret?
- Pra, si është gjendja e ujit pasi e kemi ngrirë?
- Ku në planetin tonë Tokë ka akull?

Përderisa fëmijët diskutojnë, ata vëzhgojnë shkrirjen graduale të akullit. Edukatori/ja i nxit të gjejnë zgjidhje për të liruar më lehtë dinosaurët e kapur. Fëmijët e përshpejtojnë procesin me anë të pikave/shiringave dhe ujit mesatarisht të ngrohtë. Përderisa fëmijët janë duke punuar, edukatori/ja i mbështet ata në realizimin e aktiviteteve në qendrën e artit dhe letërsisë.

Më pas, edukatori/ja ngroh një enë me ujë dhe i fton me kujdes fëmijët të vëzhgojnë avullin e nxehtë që del. Ai/ajo u tregon gjithashtu kapakun mbi të cilin tashmë janë shfaqur pika uji. Ai/ajo nxit diskutimin në lidhje me pyetjet e mëposhtme:

- Në çfarë gjendje mendoni se janë këto pika tani?
- Ku në natyrë shohim pika uji?
- Pse ndonjëherë bien nga qielli në formën e fjollave të borës?
- Çfarë ndodh me ujin kur është shumë ftohtë?
- Pra, çfarë do të ndodhë me ujin nëse e vendosim përsëri në frigorifer?

Grupi i dytë i fëmijëve punon në qendrën e artit dhe u jepet detyra të përfaqësojnë ujin në natyrë, përkatësisht me ndihmën e figurave dhe me anë të një vizatimi, ata duhet të tregojnë ujin në natyrë në tri gjendje të ndryshme agregate (të vizatojnë fjolla bore, pika uji, avull, re, shi, lumë, akull, etj.).

Grupi i tretë i fëmijëve shikon enciklopedinë për ujin dhe gjen në mënyrë të pavarur fotografitë që tregojnë akull, ujë, avujt e ujit në natyrë.

Edukatori/ja monitoron punën e fëmijëve, i drejton dhe i ndihmon nëse është e nevojshme.


#### • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE - NXJERRJA E PËRFUNDIMIT

Para të gjithë fëmijëve të grupit prezantohet gjithçka që është bërë gjatë ditës në qendrat mësimore. Edukatori/ja nxit fëmijët të shprehin mendimet dhe përshtypjet e tyre për atë që ndajnë bashkëmoshatarët e tyre. Më pas, përmes pyetjeve, fëmijët përcaktojnë edhe një herë njohuritë e fituara:

- A është uji gjithmonë në gjendje të lëngshme?
- Çfarë ndodh me të kur ngrin?
- Atëherë në çfarë gjendje shndërrohet?
- Nëse e ngrohim pas ngrirjes, çfarë do të ndodhë?
- Si mund ta kthejmë në gjendjen e tij fillestare?

#### • REFLEKTIM:

Fëmijët shprehin përshtypjet e tyre për aktivitetet e realizuara në semaforin e emocioneve. Edukatori/ja i pyet për gjithçka që u pëlqeu ose nuk u pëlqeu gjatë ditës dhe si mund ta zbatojnë atë që kanë mësuar në jetën e tyre të përditshme. Në të njëjtën kohë, ai/a jo i pyet ata se çfarë do të donin të mësonin ose të krijonin më pas.





TITULLI I TEMËS: Ekosistemi - Ndryshimet klimatike

TITULLI I TEMËS DITORE: Ariu polar

GRUPI I SYNUAR: Fëmijë të moshës prej pesë deri gjashtë vjeç

REZULTATET E PRITURA:

- Numëron disa faktorë dhe kushte themelore për jetën në Arktik.
- Përshkruan arinjtë polarë dhe kushtet e nevojshme për mbijetesën e tyre.
- Propozon disa mënyra për të shpëtuar jetën e arinjve polarë dhe kafshëve të tjera që jetojnë në Arktik.



### • PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:

#### • KOHA NË GRUP - AKTIVITETE HYRËSE

Aktivitetet fillojnë me shikimin e një video prezantimi për jetën në një vend të veçantë - Arktik. Edukatori/ja i nxit fëmijët të zhvillojnë diskutim, duke u parashtruar pyetjet e mëposhtme:

- Si duket ky vend?
- Kush jeton atje?
- Si është moti në Arktik?

Zhvillohet një diskutim me fëmijët për të kuptuar se si janë kushtet e jetesës në Arktik. Atyre u shfaqen foto të arinjve polarë. Ata i shikojnë dhe diskutojnë për atë që vëzhgojnë. Diskutohen kushtet për mbijetesën e arinjve polarë dhe bëhen pyetje të hapura:

- Çfarë u nevojitet arinjve polarë për të jetuar?
- E keni vënë re se si lëvizin në akull?
- Me çfarë ushqehen dhe si e gjejnë ushqimin?

Fëmijët përqendrohen në vëzhgimin e fotografive në sallën e aktiviteteve dhe inkurajojnë diskutimin e ndërsjellë. Nëse është e nevojshme, mund të shikojnë përsëri videon për jetën në Arktik.


Pasi japin përgjigje, fillojnë aktivitetet në qendrën hulumtuese.

#### • PUNA NË QENDRA - MËSIMI PËRMES PËRVOJËS

Fëmijët ndahen në grupe të vogla (nga katër deri në gjashtë fëmijë), në qendra mësimore (hulumtuese, letrare dhe artistike). Secili grup duhet të kryejë një aktivitet. Materialet e nevojshme të punës vendosen në qendrat mësimore dhe edukatori/ja jep udhëzime të qarta për punën e fëmijëve në qendrat mësimore.

Grupi i parë i fëmijëve punon në qendrën hulumtuese.

Vendosën copa të mëdha akulli në një enë plastike. Një pjesë e akullit është thyer për të simuluar thyerjen e mbulesave të akullit. Fëmijët zbulojnë arsyet e thyerjes së akullit përmes bisedës.



Më pas, në akull, fëmijët vendosin lodra në formën e arinjve polarë. Simulohet shkrija e akullit polar, hiqen disa copa akulli dhe shtohet pak ujë. Në mënyrë alternative, temperatura mund të rritet duke fryrë ajrin e nxehtë nga një tharëse flokësh në akull ose duke ndezur një llambë që fokuson dritën në akull. Edukatori/ja nxit diskutim për pyetjet e mëposhtme:

- Çfarë po ndodh me akullin?
- Pse po pakësohet?
- A kanë arinjtë polarë hapësirë të mjaftueshme për të jetuar?
- Nëse akulli shkrihet, a do të kenë ushqim të mjaftueshëm arinjtë polarë?
- Si mund t'i ndihmojmë arinjtë polarë?

Fëmijët përqendrohen për të kuptuar konceptin e 'ngrohjes globale'.

Grupi i parë i fëmijëve, në qendrën hulumtuese, vëzhgon shkrijen e akullit dhe i përcjell në letër përshtypjet e eksperimentit të realizuar.

Grupi i dytë i fëmijëve punon në qendrën e letërsisë, ku u jepet detyra të hulumtojnë arinjtë polarë dhe kushtet e jetesës në Arktik. Më pas, ata duhet të sugjerojnë disa mënyra për të shpëtuar jetën e arinjve polarë dhe kafshëve të tjera që jetojnë në Arktik.

Në qendrën e artit, në një copë stiropor, fëmijët krijojnë një botë polare (duke përdorur teknika të kombinuara) dhe shkruajnë një mesazh me ndihmën e edukatores për mbrojtjen e arinjve polarë nga ngrohja globale.

Gjatë kohës që fëmijët janë duke punuar, edukatori/ja drejton dhe udhëheq punën e tyre, mundëson rotacionin e fëmijëve në qendrat mësimore në mënyrë që të gjithë fëmijët të stimulojnë eksperimentet e tyre, njohuritë dhe proceset e tyre të mendimit.

## • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE - NXJERRJA E PËRFUNDIMIT

Pasi fëmijët mbarojnë aktivitetet në qendra, zhvillohet një diskutim përfundimtar dhe edukatori/ja bën pyetje:

- Pse akulli është kaq i rëndësishëm për arinjtë polarë?
- Çfarë u nevojitet arinjve polarë për të mbijetuar?
- Çfarë hanë arinjtë polarë?
- Pse akulli po shkrihet gjithnjë e më shumë?
- Si mund t' i ndihmojmë arinjtë polarë?


Fëmijët u përgjigjen pyetjeve dhe shpjegojnë ndikimin e ngrohjes globale mbi mbijetesën e arinjve polarë.

## • REFLEKTIM:

Edukatori/ja drejton një bisedë me fëmijët për përshtypjet e aktiviteteve të kryera në qendrat e mësimi të hershëm, i nxit ata të zhvillojnë një diskutim të ndërsjellë dhe të flasin për mënyrën se si ndihen gjatë hulumtimit.

- Çfarë bëmë sot?
- Cili aktivitet ishte më interesant për ju?
- Si u ndjetë?

Në fund, modeli i ndërtuar i botës polare vendoset në një vend të dukshëm në mënyrë që sa më shumë fëmijë dhe të rritur të mund të lexojnë eko-mesazhin për mbrojtjen e arinjve polarë.



A stylized illustration of a tree where the canopy is a silhouette of a human head in profile, facing left. The tree trunk is dark green, and the canopy is a lighter green with some yellowish-green patterns. In the background, there is a white cloud and a white banner with the word 'BIODIVERSITETI' in dark green capital letters. The overall background is a solid teal color.

**BIODIVERSITETI**

**MOSHA**

**PREJ 4 DERI 5 VJEÇ**

TITULLI I TEMËS: Biodiversiteti

TITULLI I TEMËS DITORE: Hotel për insekte

GRUPI I SYNUAR: Fëmijë të moshës prej katër deri pesë vjeç

REZULTATET E PRITURA:

- Numëron disa mënyra për t'u kujdesur për insektet dhe vendbanimet e tyre.
- Di të bëjë një vendbanim/habitat për insektet nga materiale natyrore.
- Kujdeset për natyrën dhe botën e gjallë në të.



### • PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:

#### • KOHA NË GRUP - AKTIVITETE HYRËSE

Aktivitetet fillojnë duke lexuar një enciklopedi për insektet, fakte të caktuara dhe më pas zhvillohet një bisedë që do t'i nxit fëmijët të diskutojnë mes tyre:

- Çfarë insektesh njihni?
- Çfarë dini për disa insekte të caktuara (mënyra e të ushqyerit, pamja, dobia)?
- Cilat janë insektet tuaja të preferuara dhe cilat insekte nuk ju pëlqejnë?
- Cilat insekte ekzistojnë më së shumti në mjedisin tonë?
- Cilat insekte janë burim ushqimi për insektet e tjera?
- Ku jetojnë disa insekte?
- A duhen asgjësuar dhe vrarë insektet?

Dilni në oborrin e çerdhes ose në rrethinat e afërta dhe filloni të grumbulloni materiale nga natyra: gjethe, degëza, bar, etj. Lërini fëmijët t'i mbledhin dhe t'i ruajnë në një kuti/qese.



#### • PUNA NË QENDRA - MËSIMI PËRMES PËRVOJËS

Fëmijët ndahen në grupe të vogla (nga katër deri në gjashtë fëmijë) në qendrat mësimore në të cilat kryhen aktivitete të caktuara me materialin e nevojshëm në dispozicion për punë (qendër arti, kërkimi dhe arti). Edukatori/ja drejton vazhdimisht punën në qendra.

Grupi i parë i fëmijëve vazhdon të punojë në qendrën e artit/krijimit. Fëmijët ndahen në çifte (në varësi të numrit të fëmijëve në grup) dhe çdo çift merr një shishe plastike, të prerë nga pjesa e sipërme dhe poshtme. Fëmijët krahasojnë hapjet e shisheve për të parë nëse janë të barabarta.

Vazhdohet me pyetje të hapura për të nxitur fëmijët në procese më të larta të mendimit:

- Si duken habitatet e insekteve dhe disa kafshëve të tjera?
- A mundemi ne, njerëzit, të kontribuojmë që insektet të kenë një jetë më të mirë?



- Si mund t'i ndihmojmë ata?
- Për çfarë mund të na shërbejnë këto shishe?
- Ku do të përdorni të gjitha pemët, gjethet, barin e mbledhur nga mjedisi i afërt?

Edukatori/ja cakton një fëmijë që të ndajë materialet natyrore të barit, degëve, gështenjave të egra, etj., me grupin e fëmijëve që fillon të punojë në qendrën hulumtuese. Fëmijët vendosin degëza, bar, gështenja të egra, etj., brenda shisheve të prera. Nëse është e nevojshme, fëmijët me ndihmën e gërsërëve dhe duke ndjekur udhëzimet e edukatorit presin ose thyejnë pemët për t'i vendosur më lehtë (futni mirë dhe fort në hapësirën e shishes së prerë që tashmë duket si hotel për insektet).

Grupi i tretë i fëmijëve kalon në qendrën e artit, ku secili fëmijë krijon individualisht insekte të ndryshme nga plastelina ose brumi me ngjyrë që ngurtësohet.

Fëmijët i bashkëngjisin insektet e tyre në habitate (hotele).

Habitateve të dekoruara dhe të përgatitura u futet një fije peri për së gjati dhe fëmijët dalin në oborrin e çerdhes dhe i vendosin jashtë, i varin në një pemë. Për të parë më hollësisht insektet, edukatori/ja shpërndan një thjerrëz dhe secili fëmijë përshkruan atë që sheh përmes thjerrëzës. Fëmijët flasin me njëri-tjetrin, krahasojnë dhe nxjerrin përfundime.


#### • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE - NXJERRJA E PËRFUNDIMIT

Para fëmijëve të grupit prezantohet gjithçka që është bërë në qendra gjatë ditës dhe përmes diskutimit ata konfirmojnë mendimet dhe përvojat e tyre praktike gjatë procesit të krijimit të habitateve për insektet. Fëmijët nxjerrin përfundim se si mund t'i ndihmojnë insektet dhe si duken ata, në çfarë lloj hapësire jetojnë dhe si ushqehen.

Në fund dilni me fëmijët në oborrin e çerdhes dhe vëzhgoni se çfarë lloj insektesh, përkatësisht çfarë insekte tashmë janë strehuar në "Hotelet e Insekteve".

• REFLEKTIM:

- Çfarë bëm sot?
- A ishte aktiviteti interesant për ju?
- Çfarë mësuat?
- Trego si je ndjerë sot:





TITULLI I TEMËS: Biodiversiteti

TITULLI I TEMËS DITORE: Ushqyes zogjsh

GRUPI I SYNUAR: Fëmijë të moshës prej katër deri pesë vjeç

REZULTATET E PRITURA:

- Zbulon mënyra të reja për t'u kujdesur dhe ndihmuar zogjtë.
- Zhvillon aftësi manuale për të bërë ushqyesin e zogjeve.
- Ndërton një qëndrim pozitiv dhe të kujdesshëm ndaj natyrës dhe botës së gjallë.



### • PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:

#### • KOHA NË GRUP - AKTIVITETE HYRËSE

Aktivitetet fillojnë brenda palestrës/sallës së ushtrimeve. Fëmijët shtrihen në shpinë dhe çlodhen duke dëgjuar tingujt e zogjve dhe duke i shijuar ato, ndërsa pas një kohe të caktuar ata përpiqen t'ia qëllojnë se çfarë lloj zogu është në varësi të tingullit që dëgjojnë. Edukatori/ja bën disa pyetje:

- Cili mendoni se është zogu që e bën këtë tingull? (fëmijët dëgjojnë me vëmendje)
- Si mendoni, a është ky zog më i madh? (lëshoni një tingull që është më i thellë dhe më i fortë)
- Cili është zogu juaj i preferuar?
- Keni një kafshë shtëpiake?
- Çfarë hanë zogjtë?
- Ku jetojnë zogjtë?
- Si mund t'i ndihmojmë ne, njerëzit, zogjtë që jetojnë në qytetin tonë?



Vazhdohet me punë në qendrat ku fëmijët do të eksperimentojnë dhe zbulojnë.

#### • PUNA NË QENDRA - MËSIMI PËRMES PËRVOJËS

Fëmijët ndahen në grupe të vogla (nga pesë deri në tetë fëmijë) në qendrat mësimore (qendra hulumtuese, konstruktive dhe e artit). Secili grup merr pjesë në aktivitete dhe përdor materialin e përgatitur paraprakisht nga edukatorja, i shpërndarë në qendrat mësimore.

Grupi i parë i fëmijëve fillon të punojë në qendrën hulumtuese. Çdo fëmijë në grup merr një pjesë të brendshme cilindrike prej kartoni nga një role e përdorur e letrës higjienike. Vendoset gjalp ose reçel kikiriku dhe fëmijët fillojnë të lyejnë cilindrat me ndihmën e gishtave ose furçave.

I lyejnë bukur e mirë dhe më pas fillojnë të lyejnë cilindrat me fara për zogj. Çdo fëmijë e mbulon cilindrin me fara, duke e mbuluar të gjithë bukur e mirë. Edukatori/ja jep udhëzime dhe fëmijët kalojnë kërpin/fijen e perit përmes cilindrit dhe më pas lidhin një nyje.



I shoqërojmë fëmijët në oborrin e çerdhës dhe ushqyesit e gatshëm të zogjve vihen mbi degët e pemëve në oborr.

Vëzhgohet se çfarë zogjsh vijjnë për t'u ushqyer. Mundohuni t'i fotografoni ato.

Grupi i dytë punon në kuadër të qendrës së ndërtimit, ku fëmijët fillojnë të bëjnë një shtëpi - një strehë për zogjtë, ndërsa grupi i tretë i fëmijëve në qendrën e artit bëjnë një mozaik me guralecë me imazhin e një zogu.

Të gjitha produktet nga tre qendrat vendosen në qendrën e ekspozitës. Fëmijët i lidhin vetë, ndërsa edukatori/ja u jep udhëzime dhe i ndihmon nëse është e nevojshme.


#### • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE - NXJERRJA E PËRFUNDIMIT

Zhvillohet një diskutim përmes të cilit fëmijët drejtohen drejt sublimimit të përvojave të fituara nga aktivitetet në grup dhe nga puna e ndarë nëpër qendra.

Fëmijët shprehin emocionet e tyre pozitive nga ndihma e dhënë dhe kujdesi për zogjtë.

#### • REFLEKTIM:

- Çfarë mësuat sot?
- Si ju pëlqeu zurma e zogjve?
- Si u ndjetë kur kujdeseshit dhe vëzhgonit zogjtë?
- Çfarë ju ka pëlqyer më shumë dhe çfarë do t'u përcillni prindërve?



**MOSHA**

**PREJ 5 DERI 6 VJEÇ**

TITULLI I TEMËS: Biodiversiteti

TITULLI I TEMËS DITORE: Pinguinët janë gjithmonë të thatë

GRUPI I SYNUAR: Fëmijë të moshës prej pesë deri gjashtë vjeç

REZULTATET E PRITURA:

- Në mënyrë aktive bën pyetje dhe shpreh gojarisht atë që ka zbuluar dhe mësuar duke vëzhguar dhe eksperimentuar.
- Arrihet në përfundim pse pinguinët janë gjithmonë të thatë.



### • PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:

#### • KOHA NË GRUP - AKTIVITETE HYRËSE

Aktivitetet nisin me një lojë të lëvizshme, përkatësisht fëmijët njihen me temën përmes lojës “Unë jam pinguin”. Edukatori/ja i ndan fëmijët në çifte dhe përmes një loje të lëvizshme, fëmijët përpiqen të kryejnë lëvizjet e një pinguini, pra me këmbët dhe krahët e bashkuar, fëmijët vendosen në rolin e një pinguini.

Në fund të lojës, disa çifte, të cilët ishin më të suksesshëm në imitimin e lëvizjeve të pinguinëve, përpiqen të lëvizin tullumbacen midis këmbëve për ta bërë lojën më argëtuese dhe motivuese.

#### • PUNA NË QENDRA - MËSIMI PËRMES PËRVOJËS

Edukatori/ja i ndan fëmijët në grupe më të vogla (nga pesë deri në tetë fëmijë) në qendrat mësimore (qendra hulumtuese, qendra arti dhe qendra ekspozuese). Edukatori/ja jep udhëzime të qarta për punën e fëmijëve me materialet e vendosura të punës.

Grupi i parë i fëmijëve punon në qendrën hulumtuese. Edukatori/ja i shpërndan secilit fëmijë një kub akulli dhe fëmijët vëzhgojnë njëri-tjetrin se kush do të jetë në gjendje ta mbajë më gjatë akullin në lëkurën e pëllëmbëve të tyre.



Edukatori/ja nxit diskutim.

- Si u ndjetë?

- Çfarë ndjeni në lëkurën e shuplakave tuaja?

- Si arrijnë ta përballojnë pinguinët të ftohtin, por ne nuk mundemi? Pse?

Grupi i dytë i fëmijëve punon në qendrën e artit dhe secili fëmijë ngjyros individualisht një aplikacion me një pinguin të vizatuar me shkurmesa vaji/dylli. Edukatori/ja i udhëheq gjatë ngjyrosjes që të ngjyrosin pjesët e pinguinit, madje edhe pjesë e bardha të pinguinit me shkurmes të bardhë. Mandej, edukatori/ja thërret fëmijët një nga një të qëndrojnë në vendin e shënuar (afërsisht një metër nga fleta e bashkangjitur). Fëmijët bëjnë një hap dhe përdorin një spërkatës për të spërkatur fletët me pinguinë dhe shikojnë pikat e ujit që kërcejnë nga pinguinët.



Fëmijët përdorin syze zmadhuese dhe vërejnë më mirë pikat që kërcejnë nga pinguini.

Grupi i tretë i fëmijëve në qendrën ekspozuese të punimeve të fëmijëve ngjitin krijimet e tyre në fije/pe me ndihmën e kapësve dhe vëzhgojnë ndryshimet në fletët e aplikimit të pinguinit.


#### • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE - NXJERRJA E PËRFUNDIMIT

Para të gjithë fëmijëve të grupit prezantohet gjithçka që bëhej gjatë ditës në qendra. Nëpërmjet bisedës nxirren disa përfundime për atë se pinguinët kanë shumë pupla të dendura dhe që së bashku mbulojnë të gjithë trupin e tyre. Pinguinët kanë gjëndra që prodhojnë vaj (dhjamë) që i bën pendët e tyre prej dylli. Dylli i pendëve largon ujin e ftohtë dhe i ndihmon të qëndrojnë të thatë.

Fëmijët nxjerrin përfundim në mënyrë të pavarur se pikat më të trasha që largojnë ujin e ftohtë nga pendët e pinguinëve krijohen për shkak të vajit që i bën pendët e tyre prej dylli - në këtë eksperiment ato janë shkumësat e dyllit/vajit me të cilat është ngjyrosur pinguini.

#### • REFLEKTIM:

- Si u ndjetë gjatë kryerjes së aktiviteteve?
- Çfarë ishte më interesante për ju?
- Çfarë mësuat?
- Si mund ta zbatoni atë që keni mësuar në jetën tuaj të përditshme?
- Trego si je ndjerë sot.



TITULLI I TEMËS: Biodiversiteti

TITULLI I TEMËS DITORE: Selino e ëmbël (bimë, rrënjë, trung, gjeth, rritet, zhvillohet, ushqehet, pranon ujë, merr frymë)

GRUPI I SYNUAR: Fëmijë të moshës prej pesë deri gjashtë vjeç

REZULTATET E PRITURA:

- Njeh/emëron pjesë të bimës.
- Emëron disa lloje të bimëve dhe e tregon dobinë që ka njeriu prej tyre.
- Numëron disa karakteristika të bimëve (rritet, zhvillohet, ushqehet, pranon ujë, merr frymë).
- Numëron ndonjë dobi nga bimët, por edhe rreziqet nga bimë të caktuara.



### • PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:

#### • KOHA NË GRUP - AKTIVITETE HYRËSE

Edukatori/ja fillon bisedë me fëmijët për bimët barishtore.


- Çfarë janë perimet?
- Cilat lloj të perimeve i dini?
- Numëroni pjesët e bimëve barishtore.
- A janë perimet ushqim i shëndetshëm?

Diskutohet për përfitimet dhe rëndësinë e konsumimit të bimëve barishtore për rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve dhe njerëzve të rritur. Nëpërmjet fotografisë njoftohen me pamjen e bimës selino. Pastaj edukatori/ja tregon shembull të selinos prej ku fëmijët i vërejnë dhe dallojnë karakteristikat e tij. Çdo fëmijë mund ta shohë nga afër, ta prekë dhe të komentojë për pamjen e tij. Edukatori/ja e përgatit selinon për ta shijuar. E qëron, e lan mirë dhe e pret në një enë, duke sqaruar se çdo bimë për të mbetur e gjallë duhet t'i pranohet materiet ushqyese nga toka në të cilën rritet. Parashtron pyetje me qëllim të nxitjes së shqisave të fëmijët:

- Çfarë ngjyre ka selinoja?
- A ndjehet era e selinos në klasë?
- Si mendoni, çfarë shije ka?
- Me cilën bimë tjetër ngjason?

#### • PUNA NË QENDRA - MËSIMI PËRMES PËRVOJËS

Fëmijët ndahen në grupe të vogla (prej katër deri), nëpër qendra për mësim (hulumtuese, letrare, artistike). Secili grup duhet të realizojë aktivitetet. Në qendrat për mësim janë vendosur materialet e nevojshme për punë, ndërsa edukatori jep udhëzime të qarta për punë nëpër qendrat për mësim.



Grupi i parë në qendrën e hulumtimeve kryen eksperiment. Për përgatitjen e eksperimentit janë të nevojshme tri gota plastike të mëdha dhe të tejdukshme.

Gotat janë të shënuara me numra (1, 2, 3). Fëmijët e kryejnë eksperimentin në mënyrë të pavarur, ndërsa edukatori/ja i drejton dhe i udhëzon. Fëmijët ndahen në çifte. Çifti i parë i fëmijëve mbush ujë në gotën numër 1 dhe i shtojnë copët e prera të selinos (gota e kontrollit në eksperiment). Çifti i dytë mbush ujë në gotën numër 2, shtojnë një deri në dy lugë sheqer dhe shtojnë copë të selinos. Çifti i tretë i fëmijëve mbush ujë në gotën numër 3, shtojnë uthull vere dhe copë të selinos. Gotat vendosen në vend të ftohtë ku duhet të qëndrojnë dy ditë. Pas dy ditëve të kaluara mund të provohet selinoja dhe të kontrollohet nëse ka ndryshuar shijen.

Edukatori/ja paraprakisht i përgatit gotat që fëmijët të mund ta përfundojnë eksperimentin dhe të formojnë njohuri nëpërmjet hulumtimit dhe përfundimeve. Fëmijët i provojnë copët e selinos nga tri gotat. Edukatori/ja i nxit fëmijët të mendojnë a ka ndodhur ndonjë ndryshim në shijen e selinos derisa i provojnë copët nga gotat e ndryshme.

Grupi i dytë ka për detyrë në qendrën për letërsi të shfletojë enciklopedi për bimët (me përqendrim në bimën selino) dhe të njihen me pjesët e saj.

Grupi i tretë në qendrën e artit e vizaton bimën selino sipas shembullit që ishte mjet i hulumtimit.

#### • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE - NXJERRJA E PËRFUNDIMIT


Para gjithë fëmijëve në grup prezantohet gjithë ajo që është punuar gjatë ditës në qendra. Edukatori/ja nis diskutim përmbyllës.

Secili grup e prezanton atë që ka punuar: eksperimentin e kryer dhe përfundimet që janë nxjerrë, pjesët nga të cilat përbëhet bima selino dhe vizatimi i selinos.

Mundësohet gjithë fëmijët të provojnë copë të selinos nga tri gotat që të mund të bisedohet dhe të komentojnë për shijen. Shije më mbresëlënëse jep selinoja nga gota me sheqer të tretur për të cilin fëmijët vetë konstatojnë se uji i ëmbël depërton në trungun e selinos.

• REFLEKTIM:

- A ju pëlqeu aktiviteti i sotëm?
- A do ta kishit bërë këtë eksperiment edhe në shtëpi?
- Çfarë mësuat sot?
- Si ndiheni sot?





TITULLI I TEMËS: Ndotja/biodiversiteti

TITULLI I TEMËS DITORE: Ndotja e lumenjve, liqeneve, deteve

(ndotja, uji i pastër, uji i ndotur, mbijetesa, sjella e drejtë/jo e drejtë e njeriut).

GRUPI I SYNUAR: Fëmijë të moshës prej pesë deri gjashtë vjeç

REZULTATET E PRITURA:

- Numëron materiale dhe sende nga rrethi i afërt që ndotin mjedisin (shishe plastike, kanoçe, qese plastike etj.).
- Dallon pasojat e sjelljes së papërgjegjshme të njeriut ndaj natyrës.



### • PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:

#### • KOHA NË GRUP - AKTIVITETE HYRËSE

Aktivitetet fillojnë me ushtrime për tendosje. Fëmijët futen në temë me dëgjimin e tingujve relaksues të valëve të liqenit, detit dhe bëjnë ushtrime në pozita të ndryshme të kafshëve të detit (delfin, peshk, breshkë, peshkaqen).

Ulen në rreth dhe bisedohet për ujin në planetin Tokë. Fëmijët tregojnë sipas kujtimeve të sendeve që kanë përjetuar kur kanë qenë afër ujit (lumë, liqen, det). Edukatori/ja drejton bisedën dhe parashtron pyetje:

- Si duket uji i pandotur, e si uji i ndotur?
- Çfarë mund të shihet në ujërat e ndotura?
- A është i dëmshëm uji i ndotur për peshqit dhe kafshët tjera që jetojnë në ujë? Sqaroni pse?
- Kush më së shpeshti e ndot ujin?

#### • PUNA NË QENDRA - MËSIMI PËRMES PËRVOJËS

Fëmijët ndahen në grupe të vogla (prej 4 deri 6 fëmijë), nëpër qendra për mësim : hulumtuese, artistike, konstruktive). Secili grup duhet të realizojë aktivitetet. Në qendrat për mësim janë vendosur materialet e nevojshme për punë, ndërsa edukatori/ja jep udhëzime të qarta për punë nëpër qendrat për mësim.

Grupi i parë punon në qendrën hulumtuese ku edukatori/ja ka përgatitur dy enë në të cilat ka pak rërë të imët dhe ngjyrë e kaltër për gatim e tretur në ujë. Fëmijëve u jepet komplet lodrash me kafshë dhe bimë me detyrë t'i ndajnë kafshët e detit dhe bimët e detit dhe t'i vendosin në dy enë.

Në enën e parë duhet ta rregullojnë vendbanimin e tyre në ujë të pastër.

Edukatori/ja i nxit fëmijët të diskutojnë nëpërmjet pyetjeve vijuese:

- Si mund të ndotet uji në lumenj, liqene dhe dete?
- Kush e ndot ujin në lumenj, liqene dhe dete?



Më pas, fëmijët marrin disa mjete për mirëmbajtjen e higjienës dhe mjete/mbetje tjera të cilat në jetën reale janë ndotës të vërtetë: shampo, detergjent për larjen e enëve, copë të qeseve plastike, stiropor, shishe/kapak plastike, kanoçe, fundëri e kafes etj. Secili fëmijë, sipas dëshirës së vet, nga materialet e ofruara shton diçka në enën e dytë me ujë të pastër.

Fëmijët vëzhgojnë si uji turbullohet dhe ndotet. Edukatori/ja përsëri nxit diskutim përmes pyetjeve vijuese:

- Çfarë mendoni, a mund të jetojnë kafshët në ujë të këtillë?
- Sqaroni çfarë do të ndodhë me kafshët në enën e dytë?
- Si duhet të veprojmë kur do të shohim se dikush hedh mbeturina në lumë, liqen, det?
- Si mund ta ndalojmë ndotjen e lumenjve, liqeneve, deteve?
- Si mund t'i shpëtojmë kafshët nga ena me ujë të ndotur?

Fëmijët japin ide të ndryshme. Para enës me ujë të ndotur janë vendosur disa sende me të cilat fëmijët mund t'i shpëtojnë kafshët, si për shembull: rrrjetë për kapjen e peshqve, brushë për dhëmbë, topa pambuku dhe të ngjashme. Fëmijët punojnë në çifte dhe zgjedhin një nga sendet e ofruara me të cilin do të mundohen t'i shpëtojnë kafshët nga ena me ujin e ndotur. Çifti i parë me ndihmën e rrrjetës për kapjen e peshqve mundohet ti përcjellë peshqit nga ena me ujin e ndotur në enën me ujë të pastër.

Çifti i dytë me ndihmën e brushës për dhëmbë mundohet t'i largojë copat e vogla të qeseve plastike, ndërsa çifti i tretë me ndihmën e topave të pambukut mundohet ta largojë fundërrinë e kafes.

Grupi i dytë punon në qendrën artistike ku marrin për detyrë që sipas idesë së tyre me ngjyra druri të vizatojnë makinë për pastrimin e ujit, e më pas të sqarojnë në cilën mënyrë do ta pastrojnë ujin e ndotur.

Grupi i tretë punon në qendrën konstruktive me detyrë që me tulla plastike të ndërtojnë makinë për pastrimin e ujit dhe të jep sqarim në cilën mënyrë e njëjta do të na ndihmojë në pastrimin e ujit.

Edukatori/ja e ndjek punën e fëmijëve, i drejton dhe u ndihmon nëse ka nevojë.


## • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE - NXJERRJA E PËRFUNDIMEVE

Para të gjithë fëmijëve në grup prezantohet e gjithë ajo që është punuar gjatë ditës në qendrat për mësim. Diskutohet dhe arrihet në përfundim se njeriu është ndotësi më i madh i ujërave natyror.

Më mirë është që secili prej nesh të kujdeset për natyrën, të mos ndotet uji me hedhjen e mbeturinave të ndryshme sepse në atë mënyrë mund t'i mbrojmë kafshët dhe bimët që jetojnë në ujë.

## • REFLEKTIM:

- Çfarë bëmë sot?
- A ishte interesant aktiviteti?
- Çfarë mësuat?
- Si mund ta zbatoni në jetën e përditshme atë që e mësuat?
- Si je ndjerë sot?





**NDOTJA**

**MOSHA**

**PREJ 4 DERI 5 VJEÇ**


TITULLI I TEMËS: Ndotja/ripërdorimi

TITULLI I TEMËS DITORE: Hije nga materiali i ripërdorur (dielli, drita - natyrale dhe artificiale, hijet, teatri i hijeve, ripërdorimi)

GRUPI I SYNUAR: Fëmijë të moshës prej katër deri pesë vjeç

REZULTATET E PRITURA:

- Shpjegon se si një objekt mund të ripërdoret për një qëllim tjetër.
- Nxjerr një përfundim për një situatë konkrete.
- Trajton siç duhet gërsërët, ngjitësin dhe materiale të tjera.
- Vizaton vija dhe forma të ndryshme me lëvizje të shumëfishta.



## • PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:

### • KOHA NË GRUP - AKTIVITETE HYRËSE

Aktivitetet fillojnë me ushtrime për zgjatje (dielli dhe ylli). Fëmijët njihen me këtë temë duke dëgjuar tinguj çlodhës të natyrës. Ata ulen në një rreth dhe flasin për diellin, dritën dhe ngrohtësinë e

- Si është moti sot?
- Çfarë ndodh kur dielli shkëlqen fort?
- A mund ta përdorim dritën e diellit?
- Si ta përdorim?

Fëmijët vëzhgojnë rrezet e diellit që bien në sallën e aktiviteteve ose në oborrin e çerdhës. Mandej, përqendrohen në vëzhgimin e hijeve që bien në dysheme ose në tokë. Bëhen ushtrime të frymëmarrjes së thellë dhe bëhen përgatitje për të shikuar një histori në teatrin e hijeve. Edukatori/ja, në një teatër hijesh të përgatitur paraprakisht, interpreton tregimin "Kush është më i fortë?" (dielli dhe era garojnë cili do të jetë i pari që do ta detyrojë njeriun të heqë pallton. Interpretimi i roleve shoqërohet me tingujt e erës dhe të diellit).

Edukatori/ja nxit një bisedë se si funksionon teatri i hijeve dhe i njeh fëmijët me informacionin se përveç diellit, drita mund të sigurohet edhe artificialisht. Analizohet funksionimi i teatrit të hijeve dhe tregohen të gjitha pjesët e tij.

- Çfarë na duhet për të krijuar dritë artificiale për teatrin e hijeve?
- Nga çfarë mund të bëhen hijet?

Fëmijët përqendrohen në faktin se hijet mund të bëhen nga çdo lloj letre e vjetër që mund të ripërdoret.



#### • PUNA NË QENDRA - MËSIMI PËRMES PËRVOJËS

Fëmijët ndahen në grupe të vogla (nga katër deri në gjashtë fëmijë) në qendrat mësimore (hulumtuese, qendra e artit). Materialet e punës vendosen në qendra.

Grupi i parë i fëmijëve punon në qendrën hulumtuese. Fëmijët analizojnë se si funksionon teatri i hijeve. Edukatori/ja ka para vetes disa role të letrës higjienike (më të mëdha dhe më të vogla). Përveç roleve, ka edhe letër të plastifikuar, letër gjurmuese ose qese të tejdukshme (foli) që lejon të kalojë drita. Nevojitet edhe një elektrik dore.

Në qendrën e artit, grupi i dytë i fëmijëve përdor rolet e letrës për të vizatuar dhe prerë modele rrathësh që duhet t'i ngjisin mbi rolet me ngjites ose një brez elastik (Ilastik). Edukatori/ja i ndihmon fëmijët të lidhin folinë mbi role me ngjites ose një brez elastik. Forma të ndryshme vizatohen me një marker sipër folisë ose letrës gjurmuese. Fëmijët duhet të krijojnë disa role në këtë mënyrë.

Hapësirat errësohen dhe ndizen dritat. Drita drejtohet drejt rolës mbi një shtresë (mund të jetë nga teatri i hijeve ose mund të jetë një shtresë e bardhë) dhe vërehen hijet që pasqyrohen në shtresë.

#### • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE - NXJERRJA E PËRFUNDIMIT

Pasi fëmijët të kenë përfunduar aktivitetet, ata prezantojnë dhe shpjegojnë se çfarë donin të vizatonin, nëse ia kanë arritur qëllimit dhe çfarë mund të ndryshojnë herën tjetër. Zhvillohet një diskutim përfundimtar dhe edukatori/ja parashtron pyetjet vijuese:


- Çfarë vizatuat?
- Keni pasur vështirësi në vizatimin e formave?
- Çfarë materiali keni përdorur?
- Nga cila letër njihen më shumë hijet?
- Për çfarë mund të ripërdoret letra?

- A keni pasur ndonjë ide gjatë kryerjes së aktiviteteve të sotme?
- Si mund të krijohen ndryshe hijet?
- Fëmijët japin përgjigjet e tyre dhe e mbyllin diskutimin me përfundime të nxjerra sipas mendimeve të tyre.

• REFLEKTIM:

Edukatori/ja bën pyetje:

- Si ndiheni sot?
- Çfarë ishte më interesante për ju?
- Çfarë mësuat?
- Si mund ta zbatoni atë që keni mësuar në jetën tuaj të përditshme?





**MOSHA**

**PREJ 5 DERI 6 VJEÇ**

TITULLI I TEMËS: Ndotja

TITULLI I TEMËS DITORE: Si ajri i lëviz sendet?

(forca e ajrit, automjete që nuk e ndotin mjedisin jetësor)

GRUPI I SYNUAR: Fëmijët e moshës prej pesë deri gjashtë vjeç

REZULTATET E PRITURA:

- Me fjalët e veta i shpreh njohuritë e fituara për erën si fenomen natyror.
- I krahason lëndët dhe materialet dhe parashikon si do të lëvizin varësisht nga forca e ajrit.
- Demonstron mënyrën e lëvizjes së CD-ve me ndihmën e forcës së ajrit.



### • PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:

#### • KOHA NË GRUP - AKTIVITETE HYRËSE

Fëmijët shikojnë video të shoqëruar me muzikë relaksuese. Në video vërehet “vallëzimi” i gjetheve të vjeshtës si rezultat i fryrjes së lehtë të erës. Vazhdojnë me aktivitetet për qetësimin e trupit duke shfrytëzuar aplikimin e lules dhe gjethit (frymëmarrje të thellë sikur nuhasin erën e lules, ngadalë nxjerrin frymë sikur të fryjnë në gjeth). Fillojnë diskutim nëpërmjet vëzhgimit të materialeve të vendosura në tavolinë: kashtë (e tërë ose e prerë në gjysmë), pupël, pambuk, pecetë, fryte bishtajore: groshë (e vogël dhe e madhe), bizele, thjerrëza. Fëmijët marrin nga një kashtë dhe fillojnë të flasnin me edukatorin/en:

- Çfarë mendoni se do të ndodhë nëse me kashtën fryni drejt këtyre sendeve? Pse?

Fillojnë të hulumtojnë duke fryrë drejt sendeve dhe mundohen t'i lëvizin. Edukatori/ja iu ndihmon të zgjedhin nga një send dhe të zbulojnë për atë:

- Çfarë mendoni se do të ndodhë nëse fryni ngadalë në këtë send?

- A do të ndryshojë diçka nëse fryni më fuqishëm?

Fëmijët mundohen në disa mënyra të fryjnë në kashtë në disa mënyra dhe vëzhgojnë efektin mbi sendin.

#### • PUNA NË QENDRA - MËSIMI PËRMES PËRVOJËS




Fëmijët ndahen në grupe të vogla (nga 4 deri në 6 fëmijë), nëpër qendra për mësim (hulumtuese, konstruktive dhe artistike). Secili grup duhet të realizojë aktivitetet. Në qendrat për mësim janë vendosur materialet e nevojshme për punë, ndërsa edukatori/ja jep udhëzime të qarta për punë.

Në qendrën hulumtuese fëmijët hulumtojnë materialet dhe ndikimin e forcës së ajrit ndaj tyre (me fryrjen në kashtë, në rul letre, me gojë).

Edukatori/ja i nxit të mendojnë duke parashtruar pyetje:

- Si i detyruat sendet të fillojnë të lëvizin?

- Si lëviz sendi (rrotullohet, rrëshqet ose kërcen) kur fryni në të nëpërmjet kashtës?



- Çfarë vëreni se është e ngjashme ndërmjet lëvizjes së sendit me fryrje të fuqishme ose të lehtë në kashtë?
- Çfarë vëreni se është e ndryshme?
- A mund ta detyroni sendin të lëvizë në distancë të njëjtë secilën herë? Si e arritët atë?

Edukatori/ja iu ndihmon fëmijëve në sjelljen e përfundimeve dhe shprehjen e perceptimeve:

- Cilat ndryshime i vërejtët?
- A lëvizin sendet më larg kur fryni më fuqishëm?
- A lëvizin më ngadalë kur fryni më lehtë?
- Çfarë i detyroi sendet të fillojnë të lëvizin?
- A ndërpresin lëvizjen të gjitha sendet në kohën e njëjtë?

Edukatori/ja iu ndihmon të përdorin fjalë me të cilat do t'i shprehin lidhjet shkak-pasojë që i kanë vërejtur: Kur....Atëherë... (Për shembull, „Kur fryva më fuqishëm mbi topin e pambukut, atëherë zhvendos më larg“.)

Në qendrën konstruktive, edukatori/ja i përfshin fëmijët në eksperiment duke spjeguar se forcën e ajrit shkencëtarët e kanë shfrytëzuar në zbulimet e tyre për zvogëlimin e ndotjes në komunikacion. Ju tregon video ku shihet si automjete lëvizin me ndihmën e fryrjes së ajrit. Demonstron mënyrën me të cilën edhe ata mund të ndërtojnë automjet duke përdorur CD dhe balon.

Fillon me shpimin e kapakut të shishes plastike me gjilpërë, ndërsa më pas kapakun e ngjet në qendrën e CD-së me ndihmën e ngjitëses së silikonit dhe pistoletës. Në vetë kapakun e ngjet balonin e fryrë duke pasur kujdes të mos lëshohet ajri. Pasi të ketë bërë këto, përsëri e drejton kujdesin e fëmijëve duke lëshuar ajrin nga baloni të cilin e mbante fortë që të mos lëshohet ajri. Fëmijët kënaqen duke ndjekur “vallëzimin” e cd-së.

Edukatori/ja i nxit në diskutim:

- Çfarë ndodh me CD-në kur baloni lëshon ajrin?
- A mund ta ndryshojmë kahjen e lëvizjes?
- Si të bëjmë që ajri të lëshohet më ngadalë nga baloni?
- A do të lëvizë njëjtë nëse e lëshojmë në sipërfaqe jo të rrafshët?

- A do të lëvizë më ngadalë nëse i ngjisim balon më të vogël?

- A mund të përdorim sende tjera përveç CD-së?

Fëmijët nxiten të vazhdojnë me hulumtim duke ndërtuar automjetet e tyre nga materiale dhe madhësi të ndryshme. Për këtë qëllim shpërndahen edhe në qendrën artistike. Fëmijët në qendrën artistike zbukurojnë CD-të duke përdorur shënues me ngjyrë dhe afishe, ndërsa më pas i ndërtojnë automjetet e veta. Inkurajohen të përpunojnë konstrukcione të ndryshme të automjeteve duke përdorur balonë, cd, pjata plastike etj.

#### • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE - NXJERRJA E PËRFUNDIMIT

Edukatori/ja organizon garë me automjetet e përgatitura. Përveç kësaj fëmijët inkurajohen të përdorin krahasime si më shpejtë, më ngadalë etj.

- Cilat CD lëvizin më larg?

- Çfarë kanë të përbashkët këto cd?

- A është e rëndësishme sipërfaqja mbi të cilin ato lëvizin për shpejtësinë e tyre?


- Përse kanë nevojë për sipërfaqe të lëmuar?

- Cilat automjete nuk lëvizën shumë larg?

- Pse është e rëndësishme të krijohen automjete që nuk e ndotin ajrin?

#### • REFLEKTIM:

Fëmijët zgjedhin simbolin përkatës dhe shprehin emocionin e vet për aktivitetet e realizuara në "Semaforin e emocioneve".



TITULLI I TEMËS: Ndotja


TITULLI I TEMËS DITORE: Si marrin frymë peshqit?

(bota ujore, frymëmarrja, verza, mbeturina)

GRUPI I SYNUAR: Fëmijë të moshës prej pesë deri 6 vjeç

REZULTATET E PRITURA:

- Përshkruan përmes fotografisë si ushqehen dhe si marrin frymë peshqit.
- I dallon pasojat e sjelljes së pandërgjegjshme të njeriut ndaj natyrës.



## • PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:

### • KOHA NË GRUP - AKTIVITETE HYRËSE

Aktivitetet fillojnë me ushtrime për tendosje dhe frymëmarrje të thellë. Të ulur në rreth, me shpinë të drejtuar dhe këmbë të kryqëzuara, fëmijët bëjnë ushtrime për qetësimin e trupit. Duart i vendosin mbi bark dhe marrin frymë thellë dy herë, ngadalë nxjerrin frymë nëpërmjet gojës katër herë. Ushtrimi vazhdon me tre thithje të ajrit dhe gjashtë nxjerrje të ajrit, gjatë të cilave përqendrimi vendoset në ngritjen dhe uljen e barkut. Edukatori/ja i pyet fëmijët duke shfrytëzuar pyetje të hapura:


- Çfarë mendoni, pse e bëjmë këtë ushtrim?
- Si duhet të marrim frymë në mënyrën e duhur?
- Pse është e rëndësishme frymëmarrja?

Fëmijët i mbulojnë hundët me duar dhe mundohen të mos marrin frymë.

- Si ndjeheni kur nuk mund të merrni frymë?
- A mund të jetojmë pa marrë frymë?
- Si marrin frymë njerëzit?
- Si marrin frymë bimët?
- Me çfarë marrin frymë kafshët?
- Si marrin frymë kafshët që jetojnë në ujë?
- Si marrin frymë peshqit?

Edukatori/ja i nxit fëmijët në diskutim dhe i motivon për pjesëmarrje duke treguar akuarium me peshk të vogël. Fëmijët e vëzhgojnë peshkun dhe diskutojnë për atë që vërejnë te ai. Diskutohet për kushtet e mbijetesës së peshkut dhe parashtrihen pyetje të hapura:

- Për çfarë kanë nevojë peshqit që të jetojnë?
- Si do ta dallojmë se peshku është i uritur?
- Si pijnë ujë peshqit?
- Si e fusin ajrin në trup?
- A ka ajër në ujë?



### • PUNA NË QENDRA - MËSIMI PËRMES PËRVOJËS

Fëmijët përqendrohen të vëzhgojnë peshkun në akuariumin në dhomën e aktiviteteve dhe nxiten në diskutim të ndërsjellë. Fëmijët përqendrohen të vëzhgojnë peshkun në akuariumin në dhomën e aktiviteteve dhe nxiten në diskutim të ndërsjellë. Pasi që t'i ndajnë mendimet e tyre, ndahen në grupe të vogla (prej 4 deri 6 fëmijë) nëpër qendra për mësim (hulumtuese, letrare dhe artistike). Secili grup duhet të realizojë aktivitetet. Në qendrat për mësim janë vendosur materialet e nevojshme për punë, ndërsa edukatori/ja jep udhëzime të qarta për punë nëpër qendrat për mësim.

Grupi i parë i fëmijëve punon në qendrën hulumtuese ku edukatori/ja ka përgatitur dy gota dhe një filtër për kafe. Fëmijëve ju sqaron se filtri është verza nëpërmjet të cilës marrin frymë peshqit.

Fëmijët vendosin filtër për kafe në majën e secilës gotë dhe i mbërthejnë me ndihmën e llastikut. Njëri nga fëmijët derdh ujë të pastër mbi njërin filtër dhe fëmijët vëzhgojnë çfarë ndodh. Në rastin e dytë, fëmijët vendosin pa pastërti në ujë (fërë, copëza pambuku etj.) dhe ngadalë e derdhin mbi filtrin tjetër, gjegjësisht mbi “verzat e peshqve”. Me ndihmën e xhamit zmadhues fëmijët i vëzhgojnë të mbeturat në filtër. Edukatori/ja spjegon se uji lëviz përmes verzave. Derisa zgjat ai proces, verzat e nxjerrin oksigjenin nga uji dhe e përcjellin nëpër trupin e peshkut. Bëhet krahasimi: ashtu si verzat nxjerrin oksigjenin nga uji që hyn në trupin e peshkut nëpërmjet tyre, ashtu edhe filtri i ndal papastërtitë e ujit. Në mënyrë të pavarur, secili grup i fëmijëve përsërit eksperimentin.

Grupi i dytë i fëmijëve në qendrën letrare hulumtojnë se si marrin frymë peshqit duke shfrytëzuar burime të ndryshme të informacionit: fotografi, enciklopedi për fëmijë, video etj. Edukatori/ja i nxit të mendojnë:

- A vëreni se ku janë verzat e peshkut në fotografi?
- Në çfarë ju ngjasojnë?
- A mund t'i numërojmë?
- Çfarë mendoni, si lëvizin?
- A janë të njëjta si mushkëritë e njeriut?
- Si dallojnë? Me çfarë janë të ngjashme?

Edhe pse vetë biseda do t'i orientojë, prapëseprapë insistohet fëmijët të konstatojnë se peshqit nuk marrin frymë si njerëzit, gjegjësisht se ata marrin frymë me verza dhe prandaj është e rëndësishme që uji në të cilin jetojnë të mos jetë i ndotur. Grupi i tretë i fëmijëve përsëri vëzhgojnë peshkun dhe nxiten për diskutim:

- Përse në ujë shfaqen filluska?
- A kanë të gjithë peshqit numër të njëjtë të verzave?
- Si marrin frymë karkalecat e detit dhe meduzat?
- A do të mund të marrin frymë peshqit nëse uji është i ndotur?
- Kush e ndot ujin në dete, liqene, lumenj?
- Si mund të parandalojmë ndotjen dhe t'i shpëtojmë peshqit?

Në letër fëmijët vizatojnë botën ujore dhe shkruajnë porosi me ndihmën e edukatorit për mbrojtjen e ujërave nga ndotja. Derisa fëmijët punojnë, edukatori/ja e orienton dhe udhëheq punën e tyre, mundëson qarkullimin e fëmijëve në qendrat për mësim në mënyrë që të gjithë fëmijët të mund me përvojën e vet të nxisin idetë, njohuritë dhe proceset e tyre të mendimit.

#### • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE - NXJERRJA E PËRFUNDIMIT

Pasi fëmijët të kenë përfunduar aktivitetet në qendrat për mësim, realizohet diskutimi përmbyllës, ndërsa edukatori/ja parashtron pyetje:


- Cilat janë pjesët e peshkut që i ndihmojnë në frymëmarrje?
- Si ishte filtri i kafës kur mbi të derdhëm ujë të papastër?
- Çfarë vërejtjet gjatë vëzhgimit me xhamin zmadhues?
- Si duhet të silleni kur shkojmë në liqen ose det?

Fëmijët përgjigjen dhe sqarojnë procesin e frymëmarrjes së peshqve. Në fund fëmijët i japin peshkut ushqim dhe e vendosin në vend të përshtatshëm në dhomën e aktiviteteve për ta mbajtur të shëndetshme.

#### • REFLEKTIM:

Edukatori/ja bisedon me fëmijët për përshtypjet e tyre nga aktivitetet e realizuara në qendrat për mësim të hershëm, i nxit të bëjnë diskutim të ndërsjellë dhe të flasin për atë se si ndihen kur hulumtojnë.

- Çfarë bëmë sot?
- Cili aktivitet ishte më interesant?
- Si ndiheshit?
- Si mund ta zbatojmë në jetën e përditshme atë që e mësuam?



TITULLI I TEMËS: Ndotja

TITULLI I TEMËS DITORE: Automjet nga baloni  
(ndotja e ajrit, gazrat e shkarkimit)

GRUPI I SYNUAR: Fëmijë të moshës prej pesë deri gjashtë vjeç

REZULTATET E PRITURA:

- Numëron mjete transporti dhe shpjegon cilët nga ato dhe në çfarë mënyre e ndotin ajrin.
- Me sukses bashkon material e konstruksionit, formon automjet sipas idesë së vet dhe ua prezanton të tjerëve.
- I dallon pasojat e sjelljes së pandërgjegjshme të njeriut ndaj natyrës.



### • PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:

#### • KOHA NË GRUP - AKTIVITETE HYRËSE




Aktivitetet fillojnë me vizitë të udhëkryqi më i afërt. Edukatori/ja orienton vëzhgimin e tyre duke parashtruar pyetjet:

- Çfarë shihni në udhëkryq?
- A kalojnë vetëm automjete?
- Kur ka më shumë automjete në udhëkryq?
- Çfarë lëshojnë ato derisa presin te semaforët?
- A mund të shihni mjet transporti që nuk ndot ajrin?
- Pse është e rëndësishme të shfrytëzojmë mjete transporti që nuk e ndotin ajrin?

Pasi të përfundojë diskutimi, fëmijët ndalen në parkingun më të afërt dhe edukatori/ja duke shfrytëzuar pecetë të bardhë mbledh një pjesë të papastërtisë së mbetur në ndonjë tub shkarkimi. Edukatori/ja ua tregon pecetën dhe diskutohet për atë se çfarë ka në të:

- Përse peceta është e papastër?
- Si del kjo papastërti nga automjetet? Ku shkon?
- Pse është shumë rrezikshëm kur ndotet ajri?
- Çfarë ndodh në mushkëritë tona?
- E me bimët dhe kafshët?
- Si mund ta zvogëlojmë ndotjen?
- A duhet të lëshojnë automjetet gazra shkarkimi që të punojnë?
- A ka automjete që nuk lëvizin me benzinë?
- Kush na ndihmon në gjetjen e automjeteve që nuk ndotin?





### • PUNA NË QENDRA - MËSIMI PËRMES PËRVOJËS

Fëmijët ndahen në grupe të vogla (prej 4 deri 6 fëmijë), nëpër qendra për mësim (hulumtuese, artistike dhe konstruktive). Secili grup duhet të realizojë aktivitetet. Në qendrat për mësim janë vendosur materialet e nevojshme për punë, ndërsa edukatori/ja jep udhëzime të qarta për punë nëpër qendrat për mësim

Grupi i parë punon në qendrën hulumtuese ku edukatori/ja ka përgatitur materiale për kryerjen e eksperimentit “Automjeti nga baloni”. Katër kapakë plastik i shpon në mes dhe nëpër to fëmijët depërtojnë shkoptha druri. I ngjisin me shirit ngjitës në fundin e shishes plastike për të krijuar bazë të automjetit. Gypi përforcohet me shirit ngjitës në grykën e balonit dhe shtyhet jashtë. Fryhet baloni dhe fëmijët shohin se si automjeti lëviz. Nxiten në diskutim:

- Kush e vuri në lëvizje automjetin? Si?
- Çfarë ndodh nëse e fryni balonin edhe më shumë?
- Çfarë ndodh nëse e përshtatni drejtimin në të cilin drejtohet kashta?
- A funksionon më së miri nëse kashta është e vendosur prapa?

Fëmijët në qendrën hulumtuese vazhdojnë me hulumtime, duke u munduar të gjejnë zgjidhje për lëvizje më të shpejtë të automjetit duke përdorur materiale të ndryshme.

Edukatori/ja i rikujton se sot edhe ata janë shkencëtarë që do të kërkojnë zgjidhje për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, i nxit të mendojnë dhe të ndërtojnë automjete që nuk do të ndotin natyrën duke përdorur edhe materiale tjera të mbetjeve (CD, gota plastike, kuti kartoni, etj.).

Grupi i dytë punon në qendrën artistike ku pranojnë detyrë që sipas idesë së tyre me ngjyra druri të vizatojnë automjet i cili nuk do ta ndotë ajrin dhe të japin sqarimin e vet se si do të punojë.

Grupi i tretë në qendrën konstruktive me detyrë që me tulla lego të ndërtojnë automjet i cili nuk do të ndotë ajrin dhe të japin sqarimin e tyre se si do të lëvizë ky automjet.

Edukatori/ja e ndjek punën e fëmijëve, dhe ju ndihmon nëse është e nevojshme.

## • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE - NXJERRJA E PËRFUNDIMIT

Pasi fëmijët të kenë përfunduar aktivitetet në qendrat për mësim, realizohet diskutimi përmbyllës, ndërsa edukatori/ja parashtron pyetje:

- Çfarë ndodhi kur shishen plastike e ndërruat me kuti kartoni?
- Çfarë ndodhi kur përdornit kashta më të mëdha ose më të vogla?
- Cilat rrota ishin më të përshtatshme për automjetin?

Fëmijët i vëzhgojnë shpikjet e tyre të shfaqura në qendrën për ekspozita të krijimeve të fëmijëve, në formë të vizatimeve dhe konstruksioneve. Secili prej tyre përfaqëson zgjidhjen e vet për mbrojtje të natyrës nga ndotja.


Diskutohet dhe arrihet në përfundim se njeriu është ndotësi më i madh. Më mirë është që secili prej nesh të kujdeset për natyrën, të mos e ndotë ajrin, sepse vetëm në atë mënyrë mund të mbrohemi ne dhe të gjithë gjallesat tjera në Tokë. Në fund, fëmijët i mbledhin materialet nga mbetjet në vendin e përcaktuar në dhomën e aktiviteteve me qëllim që edhe më tej t'i ripërdorin gjatë vitit.

## • REFLEKTIM:

Edukatori/ja bisedon me fëmijët për përshtypjet e tyre nga aktivitetet e realizuara në qendrat për mësim të hershëm, i nxit të bëjnë diskutim të ndërsjellë dhe të flasin për atë se si ndihen kur hulumtojnë.

Edukatori/ja i nxit nëpërmjet pyetjeve:

- Si u ndjetë në rolin e shkencëtarit?
- A e kishit rëndë të shpikni automjet i cili nuk do të lëshojë gazra të shkarkimit?
- Si ndjeheni tani që krijuat zgjidhje aq të dobishme?
- A e mbrojtëm ne sot natyrën? Si?
- Cili aktivitet ishte më interesant?



TTITULLI I TEMËS: Ndotja

TITULLI I TEMËS DITORE: Po e pastrojmë ujin

GRUPI I SYNUAR: Fëmijë të moshës prej pesë deri gjashtë vjeç

REZULTATET E PRITURA:

- Njeh dhe përdor mënyrat e pastrimit të ujit.
- Thekson nevojën për ujë të shëndetshëm dhe të pastër për mbijetesën, rritjen dhe zhvillimin e të gjithë botës së gjallë



### • PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:

#### • KOHA NË GRUP - AKTIVITETE HYRËSE

Aktivitetet fillojnë me shfaqjen e një videoje për ndotjen e ujit. Fëmijët njihen me temën përmes diskutimit pas shikimit të videos.

- Cilët janë ndotësit më të zakonshëm të ujit?
- Si duken lumenjtë e ndotur?
- Përmes çfarë mund të ndotet uji?
- Çfarë mund të bëjmë ne, njerëzit, që të ruajmë ujërat natyrore të pastra?

#### • PUNA NË QENDRA - MËSIMI PËRMES PËRVOJËS

Aktivitetet vazhdojnë brenda qendrave mësimore (hulumtuese, artistike dhe të letërsisë). Fëmijët ndahen në grupe më të vogla (nga pesë deri në tetë fëmijë). Secili grup ka në dispozicion një detyrë dhe materiale të përshtatshme për të kryer një aktivitet. Edukatori/ja drejton punën dhe ndihmon nëse është e nevojshme.


Grupi i parë punon në qendrën hulumtuese. Përpara fëmijëve edukatori/ja pret një shishe plastike me gërshërë dhe e vendos shishen me kokë poshtë në një gotë ose vazo të gjatë. Fëmijët ndahen në çifte dhe secili çift merr pjesë në renditjen e materialeve natyrore në shishe me të cilat do të pastrojnë ujin.

Çifti i parë rendit shtresën e parë të topave të pambukut ose pambukut, çifti i dytë rendit pëlhurën ose një filtër kafeje (kjo shtresë duhet të jetë më e trashë). Edukatori/ja vendos karbonin e aktivizuar, ndërsa çifti tjetër vendos guralecë ose zhavorr dhe, në fund, shton rërën.

Grupi tjetër i fëmijëve në qendrën hulumtuese në një tas (enë) me ujë të pastër fusin mjete të ndryshme, si vaj, detergjent për larjen e enëve, pak baltë etj., për të fituar ujë të ndotur.

Nëpërmjet xhamave zmadhues, fëmijët vëzhgojnë ujin e turbullt që e “ndotën” vetë dhe zhvillojnë një diskutim të ndërsjellë:

- Ku keni vënë re ujë të ndotur?



- Si duket uji i ndotur?
- Kush e ndot ujin?
- Si ju duket uji qe e ndotët ju?

Në hapin tjetër, uji i turbullt derdhet mbi filtrin e ujit të përgatitur tashmë dhe fëmijët shikojnë sesi uji i pastruar pikon në gotën e gjatë mbi të cilën është vendosur shishja plastike.

Parashtrohen pyetje:

- Çfarë lloj uji keni derdhur në filtër?
- Si dukej uji?
- Çfarë bëtë ju?
- Ku kanë mbetur substancat e papastra që futët për të ndotur ujin?
- Cila është ngjyra e ujit që rrodhi nëpër filtër?

Grupi i dytë i fëmijëve në qendrën e artit përpiqet të vizatojë të gjitha detajet e ujit të ndotur dhe të pastruar, dhe më pas vizatimet ekspozohen në qendrën ekspozuese të punimeve të fëmijëve, mandej analizohen dhe krahasohen.


Grupi i tretë i fëmijëve brenda qendrës së letërsisë përmes një enciklopedie që tregon shtresat e ndryshme të tokës vëzhgojnë të gjitha karakteristikat e filtrit natyror të ujit të krijuar.

#### • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE - NXJERRJA E PËRFUNDIMIT

Gjithçka që është bërë dhe mësuar u prezantohet të gjithë fëmijëve në grup. Zhvillohet një diskutim dhe nxirren disa përfundime në lidhje me pastruesin e bërë të ujit, përkatësisht, guralecët e vegjël përdoren për të ndaluar papastërtitë më të mëdha (sedimente, gjethe, insekte), rëra përdoret për të hequr papastërtitë e imëta dhe karboni i aktivizuar largon ndotësit dhe papastërtitë duke i përthith ato.

• REFLEKTIM:

- Si u ndjetë gjatë pastrimit të ujit?
- Çfarë ishte më interesante për ju?
- Si do t'i zbatoni njohuritë e fituara në jetën e përditshme?
- Tregoni se si jeni ndjerë sot:



**N DRYSHIMET  
KLIMATIKE**



**MOSHA**

**PREJ 4 DERI 5 VJEÇ**

TITULLI I TEMËS: Ndryshimet klimatike

TITULLI I TEMËS DITORE: Toka dhe uji i planetit Tokë

GRUPI I SYNUAR: Fëmijë të moshës prej katër deri pesë vjeç

REZULTATET E PRITURA:

- Dallon pjesët tokësore dhe ujore të globit.
- Njeh rëndësinë e kujdesit dhe ruajtjes së planetit Tokë.



### • PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:

#### • KOHA NË GRUP - AKTIVITETE HYRËSE

Fëmijët njihen me aktivitetet duke dëgjuar këngën "Mbaje ujin". Fëmijët e dëgjojnë këngën së bashku dhe duke analizuar disa vargje, nxitet një diskutim në grup mes fëmijëve.

Edukatorja nxit vallëzimin tek fëmijët duke kryer lëvizje të thjeshta të kërcimit sipas ritmit të këngës.

Mandej, një glob vendoset para fëmijëve që ta vëzhgojnë dhe edukatori/ja nxit bisedë:

- Çfarë ngjyra ekzistojnë më shumë në planetin tonë? Çfarë përfaqëson ajo ngjyrë?
- A e dini se cilat pjesë të Tokës janë të rrethuara vetëm me ujë? A keni qenë ndonjëherë në një ishull?
- Ku janë zonat e gjelbra? Cilat pjesë janë ato? (tregojnë me gisht)
- Ku e vëreni borën dhe akullin?
- E vëreni ngjyrën e verdhë dhe kafe? Çfarë mendoni se është?

#### • PUNA NË QENDRA - MËSIMI PËRMES PËRVOJËS


Fëmijët ndahen në grupe të vogla (nga pesë deri në tetë fëmijë), në qendrat mësimore (qendrën letrare, hulumtuese dhe artistike).

Secili grup ka një detyrë konkrete me materiale të caktuara e të siguruar në qendra.

Në qendrën e letërsisë, edukatori/ja u lexon fëmijëve disa fakte shkencore për sipërfaqen tokësore dhe ujore të planetit Tokë nga një enciklopedi. Fëmijët analizojnë fotografitë e vendosura para tyre dhe fitojnë një pasqyrë më të qartë për tokën.

Fëmijët ndahen në tre grupe në qendrën hulumtuese. Për secilin grup ka pjata të cekëta dhe të gjata, si dhe topa pambuku. Me sinjalin e edukatores numërohet vendosja e pambukut në enët. Edukatori/ja cakton dy fëmijë që kontrollojnë numrin e pambukut dhe më pas fëmijët numërojnë me zë të lartë.





Më pas, secili nga fëmijët e grupeve me ndihmën e një pikatoreje dhe ngjyrosjes ushqimore tashmë të tretur (kaltër, gjelbër, kafe) i "ngjyros" individualisht, përkatësisht pikon ujë me një ngjyrë të caktuar mbi topat e pambukut.

Pas aplikimit të caktuar të ngjyrave në topat e pambukut, edukatori/ja i nxit fëmijët të diskutojnë pyetjet e mëposhtme:

- Si ju duket topat e pambukut, çfarë ju kujtojnë?

- Si duket planeti ynë Tokë?

Pasi fëmijët të kenë ngjyrosur plotësisht topat e pambukut dhe të kenë vëzhguar pamjen dhe lagështinë e pambukut, edukatori/ja i pyet përsëri:

- Çfarë do të ndodhë nëse derdhet uji nga oqeanet, detet, liqenet jashtë shtratit të tyre?

Fëmijët i krahasojnë topat e pambukut që janë shumë të lagur (le të nisen dhe le të shohin me vëmendje derdhjen e ujit).

Gjithashtu, vëzhgimi i fëmijëve përqendrohet në ato pjesë të Tokës tashmë të ngjyrosur që kanë më shumë ngjyrë të kaltër ose gjelbër ose kafe.

Grupi i fëmijëve brenda qendrës së artit, sipas dëshirës së tyre, me ndihmën e ngjyrave të plastelinës, krijojnë rruzullin tokësor me të gjitha pjesët përbërëse të ujit dhe tokës.


#### • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE - NXJERRJA E PËRFUNDIMIT

Vëzhgimet përfundimtare lidhen me gjithçka që është bërë gjatë ditës në qendrat mësimore. Zhvillohet diskutim dhe arrihet një përfundim për ndryshimet klimatike, pra se si ne, njerëzit, ndikojmë në rritjen e nivelit të sipërfaqeve ujore dhe rrjedhimisht disa pjesë të tokës zhyten nën ujë.

Arrihet në përfundim në lidhje me ngrohjen globale dhe ndryshimet e nivelit të ujit dhe tokës, si dhe ndikimin e tij mbi jetën e gjallë.

• REFLEKTIM:

- Çfarë bëmë sot?
- Çfarë ishte më interesante për ju?
- Çfarë mësuat?
- Si mund ta përdorim atë që kemi mësuar në jetën e përditshme?
- Si u ndjetë kur po i jepnit formë planetit Tokë?
- Trego si je ndjerë sot



**MOSHA**

**PREJ 5 DERI 6 VJEÇ**

TITULLI I TEMËS: Ndryshimet klimatike  
TITULLI I TEMËS DITORE: Shkrimja e akullit  
(akull, shkrimja e akullit, viset polare dhe tropikale, ngrohja globale)  
GRUPI I SYNUAR:

Fëmijë të moshës prej pesë deri gjashtë vjeç

REZULTATET E PRITURA:

- Shpjegon çfarë do të ndodhë me mjedisin jetësor nëse rritet niveli i deteve.
- I shpreh idetë për shkaqet e rritjes së nivelit të ujit në kavanoz në eksperimentin e realizuar.
- Dallon formë agregate të ngurtë dhe të lëngët të ujit në natyrë.



### • PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:

#### • KOHA NË GRUP - AKTIVITETE HYRËSE

Aktivitetet fillojnë me dëgjimin e zërave të këndshëm dhe të pakëndshëm nga natyra (shi, erë etj.).

Fëmijët ulen në rreth dhe futen në temë me bisedë për kafshët polare.

- Ku jetojnë kafshët polare?
- Çfarë u nevojitet për të jetuar?
- Me çfarë ushqehen?
- Ku jetojnë?
- A kanë të ftohtë ndonjëherë?


Edukatori/ja lexon tregimin për “Pinguini Pino” i cili ka dashur të jetojë në viset e ngrohta. Gjatë udhëtimit deri te viset e ngrohta ai është ballafaquar me shumë pengesa, por edhe krahas asaj ai ka dashur të shohë se jeton luani në viset tropikale. Pasi që ka kaluar rrugëtim të lodhshëm, ai ka arritur në viset tropikale, por është ndjerë shumë keq për shkak të nxehtësisë atje.

Edhe pse kanë ardhur ta kontrollojnë shumë mjekë, por ka qenë papagalli ai që i ka thënë se çdo kafshë duhet të jetojë aty prej nga e ka prejardhjen.

Pinguini e ka dëgjuar dhe është kthyer në viset polare ku është lindur dhe rritur. Edukatori/ja përsëri i drejton fëmijët në diskutim: A mund të jetojnë kafshët polare në vend tjetër përveç viseve polare? E çfarë do të ndodhte nëse luani shkonte për vizitë te pinguini Pino.

Përdoren lodrat kafshë, ndërsa fëmijët bëjnë maketë të viseve tropikale dhe polare të planetit. Mund të përdoren edhe mjete tjera vizuale në varësi prej pajisjeve në dhomën e aktiviteteve.

Fëmijët bëjnë pauzë me ushtrime për zgjatje në pozita të ndryshme të kafshëve.



### • PUNA NË QENDRA - MËSIMI PËRMES PËRVOJËS

Fëmijët ndahen në grupe të vogla (prej 4 deri 6 fëmijë), nëpër qendra për mësim (të letërsisë, hulumtuese dhe artistike). Secili grup duhet të realizojë aktivitetet. Në qendrat për mësim janë vendosur materialet e nevojshme për punë, ndërsa edukatori/ja jep udhëzime të qarta për punë nëpër qendrat për mësim.

Edukatori/ja i grupit në qendrën e letërsisë u tregon fotografi nga enciklopedia për efektet e shkrirjes së akullit. Sqaron se me rritjen e temperaturave ndodh ngrohje globale e cila në masë të madhe ndikon në shkrirjen e akullit në viset polare. Fëmijët duhet të mendojnë çfarë ndodh për shkak të shkrirjes së akullit në viset polare. Njëkohësisht edukatori i rikujton se përgjigjet do t'i gjejnë në enciklopedi. Orientohen të mendojnë se shumë kafshë polare do t'i humbin vendbanimet e tyre.

Grupi i fëmijëve në qendrën e hulumtimit përqendrohet në kryerjen e eksperimentit të shkrirjes të akullit. Edukatori/ja demonstroi para fëmijëve. Në një kavanoz të madh me ujë edukatori/ja shënon nivelin e ujit. Më pas fëmijët shtojnë akull dhe para se ta lëshojnë në kavanoz i aktivizojnë shqisat e prekjes dhe analizojnë çfarë ndodh derisa e mbajnë akullin në duar. Akullin e vendosin në kavanoz, ndërsa edukatori/ja përdor tharëse flokësh ose ndonjë pajisje tjetër për ngrohje të cilën e drejton kah kavanozi me akull. Vazhdimisht i nxit fëmijët të përqendrohen në vijën e shënuar me shënues. Pasi që të shkrihet akulli, fëmijët vërejnë se niveli i ujit në kavanoz rritet dhe është mbi vijën e shënuar.

- Çfarë do të ndodhë nëse rritet niveli i ujit në oqeanë dhe dete?
- A do të vërshojë?
- A do të ketë përmytje në bregdet?
- Çfarë do të ndodhë me kafshët e ujit, e çfarë me kafshët polare?

Në qendrën artistike (të artit figurativ) fëmijët kanë për detyrë të vizatojnë çfarë do të ndodhte me botën ujore në ujëra dhe me botën shtazore polare për shkak të shkrirjes së akullnajave.

## • AKTIVITETE PËRMBYLLËSE - NXJERRJA E PËRFUNDIMIT

Fëmijët në aktivitetet përfundimtare tregojnë saktësisht çfarë kanë punuar në qendrat për mësim dhe sqarojnë nëpërmjet vizatimit çfarë do të ndodhë nëse shkrihet akulli në viset polare të planetit. Diskutohet dhe nxirret përfundim se kafshët ujore dhe ato polare do të ishin në rrezik të skajshëm sepse do t'i humbin vendbanimet e tyre.

Nëse lejon koha e paraparë për aktivitete edukatori/ja mundet në media qendrën të shfaq film të shkurtë dokumentar për pasojat e shkrirjes së akullit për shkak të ngrohjes globale. Me fëmijët bisedohet në drejtim të nxjerrjes së përfundimeve për temën.

## • REFLEKTIM:

- Aktivitetet përfundojnë me diskutim refleksiv me fëmijët.
- Si ndiheni sot në kohën e aktiviteve?
- Cila pjesë ishte më interesante për ju?
- Çfarë mësuat sot?
- Si mund ta zbatoni në jetën e përditshme atë që mësuat?

